




28 NËNTOR
1912-2023

**Programi edukativ
i shkollave shqipe
nga Artur Shkurti**

OLIMPIADA XXIII KOMBËTARE PËR GJUHËN SHQIPE

KONKURS I RECITIMIT TË POEZISË SHQIPE
PËR FËMIJËT JASHTË ATDHEUT



Arbana Cura, Ulqin
fituese, nëntor 2022



HYRJE NË PROGRAMIN EDUKATIV TË SHKOLLAVE SHQIPE QË VEPROJNË JASHTË ATDHEUT

Nga Artur Shkurti

Drejtor i shkollës “Udha e shkronjave”

Të nderuar mësues e drejtues të shkollave shqipe,

Të nderuar prindër që jetoni jashtë atdheut,

Detyra e përbashkët është të ruajmë gjuhën dhe kulturën shqipe dhe ta bëjmë këtë proces një mjet të fuqishëm për mbijetesën tonë si komb dhe për të forcuar lidhjet me atdheun tonë Shqipërinë, me synim final kthimin në atdhe të sa më shumë të larguarve ose mbijetesën si shqiptarë në dhe të huaj. Objektivi i kthimit ndryshon nga individ në individ, nga familja në familje, por ajo që dihet është se në çdo rast fëmijët do të bëhen shtysë ose pengesë dhe kjo do të varet nga edukimi që do të marrin, nga përvojat që kanë në vend të huaj, nga lajmet që vijnë nga Shqipëria, nga frymëzimi që japin fiset, nga malli ose jo e shumë faktorë të tjerë.

Është viti i dytë që ne organizojmë *Konkursin e Recitimit të Poezisë Shqipe* me pjesëmarrjen e nxënësve shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut. Në këtë gjë, “Udha e shkronjave” po shfrytëzon përvojën e saj të gjatë me Olimpiadën Kombëtare, me moshat 5-16 vjeç. Kemi që nga viti 2000 që punojmë në gjuhë shqipe, matematikë, shkencë, kompetencë globale me nxënës të shkëlqyer të Shqipërisë dhe të Kosovës. Mbi 10 000 nxënës kanë marrë pjesë në këto olimpiada kombëtare ose lokale. Misioni ynë ka qenë që fëmijët shqiptarë të kenë mundësi të shohin qartë fuqinë e vetes, shkëlqimin e tyre, aftësinë e tyre trashëguese dhe problemet që lidhen me këtë. Gara bëhet kështu mjet i dëshimit të shkëlqimit kombëtar në trashëgim, mjet i dashurisë për vendin dhe kombin. Ne i ftojme prindërit ta shfrytëzojnë këtë rast

Kështu e shohim edhe konkursin e recitimit me video të poezisë shqipe. Tashmë që jeni larg atdheut, ju keni më shumë mundësi të vlerësoni në mënyrë objektive se populli ynë, parë historikisht, është një popull fisnik, me kulturë të veçantë, me shumë tipare pozitive e me mundësi të jashtëzakonshme zhvillimi. Nga puna e shqiptarëve bota mund të përfitojë shumë, por mirë është që më parë të përfitojë Shqipëria dhe shqiptarët.

Në këtë broshurë do të gjeni poezitë e programit të konkursit por edhe disa propozime mbi konceptimin e shkollave shqipe, organizimit, financimit të tyre, si edhe orientime edukative.

Kryesisht ky program është nxjerrë nga libri *“Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë”* (Artur Shkurti, 2009) dhe nga libri *“Gjuha shqipe”* (Artur Shkurti, 2014). Pjesën kryesore që është e ndarë sipas klasave ne nuk e kemi ndryshuar, por sivjet kemi shtuar disa pjesë shtesë që kanë të bëjnë me një furnizim edhe më të mirë të nxënësit me figura që janë kyçe për të kuptuar Rilindjen Kombëtare. Kemi shtuar pjesë nga eseja e Lasgush Poradecit “Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri” (1946), poezi nga Pashko Vasa, fjalë të urta nga Sami Frashëri, kujtime nga Sevasti Qirjazi për Naim Frashërin. Kështu nxënësi shqiptar që jeton jashtë atdheut do të një kompozim të fuqishëm të figurave qendrore dhe emblematiche të autorëve frymëzues të Rilindjes Kombëtare.

Në faqen e Olimpiadës Kombëtare (www.olimpiadakombetare.com) kemi botuar shumë video-recitime që do të jenë shembuj për nxënësit. Në vitin 2016, në kuadër të 170 vjetorit të lindjes së Poetit Kombëtar Naim Frashëri, organizuam të parin konkurs të recitimeve me video. U mrekulluam nga rreth 200 recitime që na dërguan nxënësit e Olimpiadës XVI Kombëtare (2016). Një pjesë të mirë të tyre i gjeni në faqen tonë në youtube.



Vjet, në nëntor 2022, organizuam konkursin e parë të recitimit me poezi shqipe me pjesëmarrjen fëmijëve që jetojnë jashtë atdheut. Videot e recitimeve i gjeni të botuara në faqen tonë. Në to kanë marrë pjesë edhe nxënës të Olimpiadës XXII Kombëtare që krahas recitimit realizuan edhe një tezë me shkrim. Kjo ishte një përvojë e veçantë e shkollës “Udha e shkronjave”. Në kuadër të kësaj olimpiade patëm mundësi të botonim një sërë artikujsh që vinin në fokus ndihmën ndaj shkollave shqipe në emigracion.

- Financimi i shkollave shqipe me fonde familjare
- Projektligji për ndihmën ndaj shkollave shqipe duke shfrytëzuar ndihmën
- Analizë e problemeve me programet shtetërore të gjuhës shqipe për diasporën

Pse vlen recitimi i poezive në gjuhën shqipe për punën e një shkolle shqipe në diasporë?

Recitimi është projekti më i bukur e performancës së një nxënësi në gjuhë shqipe. Recitimi bëhet “lokomotivë” e fuqishme që tërheq fort nxënësit dhe mësuesit e tyre drejt mësimit të gjuhës shqipe në shumë komponentë kua analiza e tekstit që do të recitohet është kryesore. Jo rrallë kjo punë bëhet në gjuhë të huaj dhe pastaj nxënësi kalon në gjuhë shqipe. Nxënësi mban shënime, bën më shumë prova derisa ta realizojë me sukses. Gjatë kësaj kohe që ai përvetëson poezinë, poezia shqipe fillon e lëshon rrënjë të thella në shpirtin e tij, e prek atë emocionalisht, e bën të gatshëm për identifikimin e tij si shqiptar. Kjo nuk është e lehtë, por poezia, gjuha dhe letërsia shqipe ia arrin ta bëjë. Vetë konkursi ynë i siguron nxënësit shumë shoqëri. Ai pret me kureshtje të shohë se çfarë kanë dorëzuar të tjerët. Interesi ynë është që ai të frymëzohet prej kësaj, ta shohë veten pjesë e një komuniteti global shqiptarësh që përpiqen dhe kanë sukses në ruajtjen e gjuhës, të kulturës dhe të traditave. Provë për këtë është konkursi i vjetshëm. Ne që jemi organizatorë ngelëm të befashuar me emocionet që morëm nga shumë drejtime.

Fëmija dhe mësuesi do të përfshihen në një diskutim të thellë për kuptimin e mesazhit që transmeton poezia, për të ditur më shumë për autorin që do të jetë i shquar, për të mësuar më shumë për fjalë, shprehje. Do të bëhen lidhje me Historinë e Shqipërisë, me njohjen e dialekteve, krahinave nga vijnë autorët. Disa data do të fillojnë të fiksohen. Shumë struktura gjuhësore do të fiksohen dhe do të transferohen shpejt si modele për të ndërtuar komunikim gjithnjë e më të mirë.

Ne e kuptuam edhe nga përvoja e vjetshme se recitimet



Gjuha shqipe

janë në gjendje të prekin thellë zemrat e shqiptarëve në emigracion apo në Shqipëri dhe t’i bëjnë ata të reflektojnë thellë mbi fatin e tyre.

Video-recitimet janë investim i fuqishëm tek fëmijët dhe prindërit duhet ta duan këtë punë. Nuk është me shumë rëndësi përkryerja e recitimit, sa dëshira për t’iu bashkuar udhës së shkronjave shqipe.

Fiset e fëmijëve që janë në Shqipëri mezi presin të shohin një përfshirje të tillë të fëmijëve që jetojnë jashtë atdheut.

SI TË REGJISTROHENI?

Dërgoni një mesazh interesi në (355) 692076068 në whatsapp ose një mesazh me e-mail në adresën: info@udhaeshkronjave.edu.al Ne do t’ju ofrojmë udhëzime shtesë dhe do të bashkëpunojmë vazhdimisht me ju që ju të keni një përfaqësim sa më të mirë.

MBI 80 RECITIME NË VITIN 2022

Në konkurrimin e vjetshëm ne patëm pjesëmarrje nga katër shkolla në Mal të Zi, tri shkolla shqipe në Itali (Bolzano, Merano, Bari) dhe disa shkolla nga Shqipëria. Më poshtë lista e nxënësve që patën recitime të poezive shqipe.

Shkolla shqipe Merano, Lana, Itali

Amina Myftari (Merano, Lana, Itali)
Katerina Xheta (Merano, Lana, Itali)
Alda Tusha (Merano, Lana, Itali)
Kevin Tusha (Merano, Lana, Itali)
Amarda Dumani (Merano, Lana, Itali)
Brikena Dumani (Merano, Lana, Itali)
Megi Dumani (Merano, Lana, Itali)
Abiona Kupa (Merano, Lana, Itali)
Eva Kupa (Merano, Lana, Itali)
Imran Kupa (Merano, Lana, Itali)

Melisa Begu (Merano, Lana, Itali)
Orkida Mikli (Merano, Lana, Itali)
Nerilda Xheleshi (Merano, Lana, Itali)
Hana Jashari (Merano, Lana, Itali)
Diellëza Jashari (Merano, Lana, Itali)
Florina Vrenezi (Merano, Lana, Itali)
Kreshnik Berisha (Merano, Lana, Itali)

Shkollat shqipe të Malit të Zi

Arbana Cura (Boshko Strugar, Ulqin, Mali i Zi)
Ermina Draga (Gjergj Kastrioti, Ostros, Krajë, Mali i Zi)
Ildorina Lekperi (Gjergj Kastrioti, Ostros, Krajë, Mali i Zi)
Arianit Gjokaj (Bashkimi, Skorraç, Tuz, Malësi, Mali i Zi)
Aisa Dermaja (Medrese, Podgoricë, Mali i Zi)
Pranvera Djonbajljaj (Medrese, Podgoricë, Mali i Zi)
Rumejsa Kacaj (Medrese, Podgoricë, Mali i Zi)
Teuta Ljuljanaj (Medrese, Podgoricë, Mali i Zi)

Shkolla shqipe “Shqiponjat e mëndafshta”, Bari, Itali

Alessandro Giovanni Armenisse (Bari, Itali)
Esilda Berisha (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Mattia Bano (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Ester Deçolli (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Chiara Maffia (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Yara Kristuli (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Alessio Gjura (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)
Francesco Cardinale (Shqiponjat e mëndafshta, Bari, Itali)

Shkolla shqipe “Artur Lleshi”, Bolzano, Itali

Lamberta Çausi (shkolla “Artur Lleshi”, Bolzano, Itali)
Ramirjo Zenuni (shkolla “Artur Lleshi”, Bolzano, Itali)

Shkolla “Udha e shkronjave”, Tiranë

Aba Gega, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Agnes Metani, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Abigail Michelle Bilbili, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Etjen Haxhillari, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Ismo Balilaj, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Dritan Gega, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Ina Bruçi, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Emili Vladi, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Elodi Bajramaj, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Chelsea Edina Aliaj, “Udha e shkronjave”, Tiranë
Kamila Vladi, “Udha e shkronjave”, Tiranë

Recitues nga shkolla publike dhe private në Shqipëri

Ildi Murataj, Ballsh
Kevin Kullau, Berat
Ranja Pashallari, Berat
Arb & Diellza Shehdula, Durrës



Gjuha shqipe

Daniel Babamusta, Durrës
Agnes Canaj, Fier
Joana Poçi, Fier
Alesia Isaraj, Gjirokastër
Siona Hasula, Librazhd
Aleksandro Peko, Tiranë
Noel Miraka, Tiranë
David Kalefi, Tiranë
Kledia Meta, Tiranë
Enes Allmeta, Tiranë
Mishel Nake, Tiranë
Klesti Spahiu, Tiranë
Dion Allka, Tiranë
Erdet Balilaj, Tiranë
Nadia Blacëri, Pogradec
Alvi Qeva, Pogradec
Noels Likollari, Prrenjas
Irsa Balla, Prrenjas
Erla Xhaferaj, Vlorë
Klea Sofia Andrea, Vlorë

Grupi i gjuhës shqipe nga Eruglina Haskaj (Gjirokastër)

Elhaida Sinani (Gjirokastër)
Emiliano Horaj (Gjirokastër)
Emanuela Horaj (Gjirokastër)
Aisel Kuka (Gjirokastër)
Emelia Shametaj (Gjirokastër)
Mateo Haska (Gjirokastër)
Donald Hatika (Gjirokastër)
Gjenovefa Kore (Gjirokastër)
Seraina Sinani (Gjirokastër)
Joriseld Nebiaj (Gjirokastër)
Justin Doçi (Gjirokastër)
Suela Sela (Gjirokastër)
Graciela Baho (Gjirokastër)
Najada Çelo (Gjirokastër)

NXËNËS PJESËMARRRËS NË KONKURSION “UDHA E SHKRONJAVE” RECITIMI I POEZISË SHQIPE, NËNTOR 2022





Lasgush Poradeci



“Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri” (1946)

Lasgush Poradeci është trashëgues dhe analizuesi më i mirë i Rilindjes Kombëtare. Ai na tregon procesin krijues të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare dhe ndikimin e Naim Frashërit. Është me shumë rëndësi për shkollat shqipe që të kapin thelbin dhe t’ua thonë fëmijëve.

SHËNIM: Propozohet për recitim në grup nxënësish ose individualisht.

“Letrëkëmbimi i Sami Frashërit i drejtuar Bukureshtjanëve, si një mjet që kish për objektive bindjen e arësyes, ish i pa aftë t’i-a arrijë qëllimit me anën e gjykimeve të stilit epistolar, të thatësirave të prozës. Bukureshtjanët e mbanin prej vetvetiu më-të-lartë mburrjen për emrin e tyre shqiptar. Prej vetvetiu e kishin inaguruar ata, në të huaj, traditën e ndjenjës kombëtare. E përvetësonin pabiseduarsisht idenë e bashkimit. Po kush i bindte për sinqeritetin e palës tjetër për atë bashkim, që pretendohet dyke u mohuar anasjelltas? Nuk ish kjo në fuqinë e njeriut, në fuqinë e thjeshtë të njeriut shqiptar, edhe kur ay njeri mund të thuhej Sami Frashëri. Ishte çështje fetare, punë feje, feja e Shqiptarit- ishte feja e shqiptarisë dhe për fenë flasin profetët jo njerëzit. Për fenë e shqiptarisë do të fliste profeti i kombit shqiptar: Naim Frashëri. Ky do të bënte Këthimin e Shqiptarëve.

Ëngjëlli i Zotit të Shqipërisë, Ideja e mirë e atdheut, Zëri i shpëtimit kombëtar i thotë Samiut:

... Dërgo në Bukuresht ca këngë të Naimit...

Dhe kështu Sami Frashëri i-u shkroi edhe një herë Shqiptarëve të Bukureshtit, i-u dërgoi letër përsëri. Letra tashi nuk ish, si më parë, një gjë kryesorë, kryesorinë e kishin vargjet, vjershat shqip të naim Frashërit. Përsëri ata e lexuan Saminë, dhe si e kuptuan përsëri dhe përsëri s’u bintnë, e mbyllnë letrën si më parë përsëri. Kënduan pastaj këngët e Naim Frashërit



dhe shpirti i tyre u tund. Ata nuk i mbyllnë fletët e vjershave, s’ i mbyllnin dot. S’ngopeshin së kënduari. Kishin gjetur atje të vërtetën, e kishin kuptuar dhe u bintnë. U bintnë sepse e kishin ndjerë në zemër, i-u ish kulluar zemra, qenë bërë të pastër dhe të pafajshëm si foshnja. Ç’far kishin ndjerë ata në ato vjersha, për ç’far ishin bindur? Për një gjë të thjeshtë, shumë të thjeshtë, po e cila e pandjerë i-u rëndonte vetëdijen si plumb: ishin bindur se myslimanët e Stambollit nuk qenë- Turq po Shqiptarë orthodhoksët e Bukureshtit. Ato vargje të Naimit mbanin zemrën e kombit në dorë; flisnin drejt nga zemra dhe hynin drejt në zemër. Ishin simboli i lavdisë dhe i besimit të të gjithë Shqiptarëve:

Bota që kur është zënë,
Shqipërija gjall ka qënë:
Pellag’ u theshin më parë,
Më se fundi Shqipëtarë.
Kemi patur mbretëria
Edhe fort shumë të mira:
Aleksandr’ i math q’ i thonë,
Ay ish nga fara jonë;
Pirrua qe nga Shqipërija,
Q’ e lëvdon gjithë historia.
Skënderbegu Kastrioti,
Q’ u dëftye aq i zoti,
Q’ i dha dërmënë Turqisë,
Ishte bir i Shqipërisë.
Ç’ burra kishte Shqipërija,
Q’ i ka shkruar historia:
Bajraktarë- e Qypriinë,
Shkodranë- e Mehmet-Alinë,
Xhavellën e Marko-Sulë,
Bubullinë- edhe Mjahulë,

Q' i dhanë dërmën Turqisë
Dh' i vunë nder Shqipërisë.
Po nga gjithë trimërija
Nuk fitoj gjë Shqipërija;
E ç' e desha trimërinë,
Kur s' m' u ndoth për Shqipërinë?
Me nder t' ënë roj Turqija,
Po sot vuan Shqipërija,
Ka vuar edhe po vuan-
Turqit neve a na duan?
S' duan fare të na shohin,
Shqipërinë sot s' e njohin.
Mos durofsh, i madhi Zot,
Të rimë në zgjedhë sot!
Se me punë kaq të vyer,
Ne më s' jemi të gënjyer:
S' jemi Turqër as kaurë,
Mos e thoni këtë kurrë!
S' jemi Grekër as Bullgarë,
Jemi vetëm Shqipëtarë!

Kur kënduan këto fjalë të adhuruara, veteranët e Lëvizjes së Bukureshtit i njomnë sytë me ngashërim dhe larguan çdo dyshim e drojtje, çdo frikë prej vëllezërve të tyre të Stambollit; sepse sikundër e rrëfenin vargjet e Naimit, këto dhe të tjera, të mbushura plot me urrejtje kundër pushtonjësit dhe robëronjësit turk, vëllezërit e tyre të Stambollit nuk qënksnin asfare Turq besnikë të Sulltanit po myslimanë shqiptarë, Shqiptarë të vërtetë, dhe Shqiptarë të djegur me



Gjuha shqipe

njëmijë zjarre për Shqipërinë. Mblidhen atëhere veteranët e Bukureshtit e tok pa humbur kohë, bëjnë Shoqërinë shqiptare të tyre, blejnë shtypëshkronjën shqiptare të tyre, shtypin librat shqip të Naimit të tyre, mbushin Shqipërinë me libra shqip, mbushin Shqipërinë me shkolla shqip, mbushin Shqipërinë me ndjenja shqiptare, mbushin qytetet e Shqipërisë me klube shqiptare, mbushin malet e Shqipërisë me çeta shqiptare, me ato çetat e para të Lirisë shqiptare të cilat- dyke vazhduar traditën e gjallë të bashkimit kombëtar besimtar të Naim Frashërit, të bashkimit të math shqiptar- do të bëheshin çetat, batalionet, brigadat dhe divizionet e më pastajme të ushtërisë shqiptare, çlirimtare e përjetëshme e atdheut."



Nxënës të shkollës "Udha e shkronjave" (Agnes Metani dhe Abigail Bilbili) duke recituar pjesë nga eseja "Misioni i Shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri" para trashëgimtarëve të Vëllezërve Frashëri dhe të Lasgush Poradecit (në foto Marie Gusho), më 25 maj 2023, përkujtimi i lindjes së Naim Frashërit.



PASHKO VASA

**Autori i devizës së Rilindjes Kombëtare
“Feja e shqiptarit është shqiptaria”**

Është me rëndësi për nxënësit të mbajë mend një radhë jo aq poetike, sa patriotike. Sado të bukura të jenë poezitë, vlera e tyre matet me ndikimin që ato kanë: a është ky ndikim pjesëror, individual, krahinor, kombëtar apo thjesht njerëzor.

Ne kontekstin e fëmijëve që jetojnë jashtë atdheut ne duam të rritim shqiptarë dhe nëse ka pak emra që duhet të mbeten në kujtesën e fëmijës, një prej tyre duhet të jetë Pashko Vasa, që ishte në grupin e ngushtë udhëheqës të Rilindjes Kombëtare. Ndërkohë që këshilla e tij në poezi shkon sa tek kombëtarja, sa tek fetarja, tek njerëzorja, tek dashuria, ne kemi zgjedhur disa strofa dhe poezinë e famshme “O moj Shqypni”.



Gjuha shqipe

Si atje n'empir të lartë,
ku Hyu qëndron gjithmonë,
këndojnë shpirtat me fletë
krejt himnin e fesë sonë,
t'mbarën i bien njerëzimit
me vepër t'lartë mirësie.

Po çfarë bëjnë ata t'mjerë në anije,
të munduar kaq fort prej stuhisë?
Një vullnet aty mes fatkeqësisë
shpërthen n'britmën: Pra, duhet luftuar!

Ne q'një shekull më fisnik e t'urtë
ndjekim një rrymë, medet, tepër të vrullshme
edhe ngremë sytë edhe krenarë sodisim
në rritje qytetërimin, ne që s'ngopim
ndërgjegjen tonë me fjalë të rënda e boshe
pa shije e pa kuptim, ne që me t'madhe
thërresim n'mbrojtje tonë emrin e shenjtë
t'lirisë s'mendimit ashtu edhe të kultit;
ne nga shenja t'tjera më të vërteta
e gjykojmë jetën.

O moj Shqypni!

O moj Shqypni, e mjera Shqypni,
Kush t'ka qitë me krye n'hi?
Ti ke pas kenë një zoj' e rand,
Burrat e dheut t' thirrshin nan.
Ke pas' shumë t'mira e begati,
Me varza t'bukura e me djelm t'ri,
Gja e vend shumë, ara e bashtina,
Me armë të bardha, me pushkë ltina,
Me burra trima, me gra të dlira;
Ti ndër gjith shoqet ke kenë ma e mira.
Kur kriste pushka si me shkrep moti,
Zogu i shqyptarit gjithmonë i zoti
Ka kenë për luftë e n'luftë ka dekun
E dhunë mbrapa kurr s'i mbetun.
Kur ka lidhë besën burri i Shqypnisë,
I ka shti dridhën gjithë Rumelisë;
Ndër lufta t'rrepta gjithëkund ka ra,
Me faqe t'bardhë gjithmonë asht da.

Por sot, Shqypni, pa m'thuj si je?
Po sikur lisi i rrxuem përdhe,
Shkon bota sipri, me kambë, të shklet
E një fjalë t'ambël askush s'ta flet.
Si mal me borë, si fushë me lule
Ke pas qenë veshun, sot je me crule,
E s'të ka mbetun as em'n as besë;
Vet e ke prishun për faqe t'zezë.
Shqyptar', me vllazën jeni tuj u vra,
Ndër një qind çeta jeni shpërnda;
Ca thonë kam fë, ca thonë kam din;
Njeni "jam turk", tjetri "latin";
Do thonë "Jam grek", "shkje" disa tjerë,
Por jemi vllazën t'gjith', more t'mjerë!
Priftnit e hoxhët ju kanë hutue,
Për me ju damun me ju vorfnue!
Vjen njeri i huej e ju rri n'votër,
Me ju turpnue me gru e me motër,
E për sa pare qi do t'fitoni,
Besën e t'parëve t'gjith e harroni,
Baheni robt e njerit t'huej,
Qi nuk ka gjuhën dhe gjakun tuej.



Gjuha shqipe

Qani ju shpata e ju dyfeqe,
Shqiptari u zu si zog ndër leqe!
Qani ju trima bashkë me ne,
Se ra Shqypnia me faqe ndhe!
E s'i ka mbetun as bukë as mish,
As zjarm në votër, as dritë, as pishë;
As gjak në faqe, as nder ndër shokë,
Por asht rrëxue e bamun trokë!
Mblidhniu ju varza, mblidhniu ju gra,
M'ata sy t' bukur q' dini me qa,
Eni t'vajtojmë Shqypninë e mjerë,
Qi mbet' e shkretë pa em'n, pa nder;
Ka mbet e vejë si grue pa burrë,
Ka mbet si nana, qi s'pat djalë kurrë!

Kujt i ban zemra m' e lan' me dekë
Kët farë trimneshe, qi sot asht mekë?
Këtë nanë të dashtun a do ta lamë,
Qi njeri i huej ta shklasë me kambë?
Nuk, nuk! Këtë marrë askush s'e do
Këtë faqe t'zezë gjithkush e dro!
Para se t'hupet kështu Shqypnia,
Me pushkë ndorë le t'desë trimnia!
Coniu, shqyptarë, prej gjumit çoniu,
Të gjithë si vllazën n'nj besë shtërngoniu,
E mos shikoni kisha e xhamia:
Besa e shqyptarit asht shqyptarial!
Qysh prej Tivarit deri n'Prevezë,
Gjithkund lshon dielli vapëdhe rrezë,
Asht tok' e jona, prind na e kanë lanë
Kush mos na e preki, se desim t'tanë
Të desim si burrat që vdiqnë motit
Edhe mos marrohna përpara zotit.



Samii Frashëri

Ideologu i Rilindjes Kombëtare

Është me rëndësi për një fëmijë shqiptar të shkollës shqipe jashtë atdheut që të arrijë të mësohet prej Sami Frashërit në një mënyrë sa më të thjeshtë, të tillë që ai vetë do ta vazhdojë vetë kur të rritej, por duhet që fara të hidhet nga shkollat shqipe në kohën e duhur dhe saktë. Të mësuarit e Sami Frashërit është të mësuar të Rilindjes Kombëtare. Në këtë mënyrë Sami Frashëri do ta bëjë gati fëmijën që të hetojë më shumë. Detyra e shkollave shqipe është ta fillojnë saktë, ndërsa mbarimi nuk është në duar të tyre.

Atdheu është trashëguesi i vërtetë i njeriut, madje edhe eshtrat e tij mbeten atdheut.

Është i marrë njeriu që nuk lë trashëgimi për atdheun, për të cilin edhe kur të jetë duke dhënë shpirt të mos shkrijë gjithçka, sepse atdheu nuk e harron mirësinë që i bëhet, ndërsa trashëgimtari, pasi të shtjerë në dorë trashëgiminë, ndodh që ta mallkojë të zotin e saj.

Posatëfillojnë të shkëlqejnë doket e mirat të një kombi që është duke u zhdukur e që kanë filluar të zënë ndryshk, shfaqen menjëherë heronjtë, të cilët engjallin kombi sipër mrekulli.

T'i ndalosh me anë të forcës zakonet e liga të kombit, do të thotë t'i shpallësh luftë atij. Gjëja që nevojitet është të ngresh kombin në një shkallë të atillë që të heqë dorë vetë nga zakonet e liga.

Atdheu edhe po u la në dorë të një qeverie të ligë, edhe po u shpërfill, pëson fatkeqësi të shumta, po nuk e humb shpresën se më në fund do të shpëtojë, por premtimet e të huajve dhe mbrojtja që ata mund të ofrojnë, gjithmonë sipas interesave të tyre, e zhdukin atdheun përgjithmonë.



Sado i pafuqishëm të jetë opinionin publik, prapëseprapë është i aftë të frikësojë tiraninë. Ky është shkaku që një qeverisje mizore, në pamundësi për të shkatërruar dhe zhdukur një opinion publik kundërshtar, përpiqet ta mashtrojë atë dhe ta vërë në gjumë me dhëlpëri.

Opinionin publik edhe pse në pamje të parë mund të duket i dobët, në të vërtetë është shumë më i fortë nga sa duket dhe është i aftë të shkatërrojë çdo forcë materiale.

Asnjë ligj nuk mund ta sundojë opinionin publik. Vetëm ai nuk mund të mposhtet me anë të ligjit.

Nuk mund të jetë i mirë morali vetjak i çdo qytetari, kur është shprishur morali i përgjithshëm i popullit.

Trazimet dhe rebelimet e brendshme të një shteti i ngajnë një dhimbje koke dhe përzjerjes së stomakut; ndërsa ndërhyrja e jashtme është si plaga e shkaktuar nga një plumb i rrezikshëm.

Krenaria ka shkaktuar prishjen e shumë shteteve dhe kombeve.

Qeverisja e racës njerëzore me anë të edukimit, është shumë më e lehtë se qeverisja me anë të ligjit.

Ashtu si njeriu përbëhet nga shpirti dhe jo nga forma, edhe kombi përbëhet jo thjesht nga individë të veçantë, por nga opinionin publik. Një popull që nuk ka opinion publik, nuk mund të bëjë pjesë në familjen e kombeve të qytetëruara.

Ajo që e bën të lumtur një komb, nuk është vetëm mendja dhe zotësia e udhëheqësit të tij, por kryesisht janë morali dhe natyra e tij.

Shturja është një lumë i rrëmbyer që ecën midis popujve dhe i rrëmben popujt që janë mbrojtur me muret e një morali të mirë dhe me anën e një administrimi të mirë i dërgon nëpër grykëderdhje pranë detit ku ato janë të paracaktuar të mbyeten.

Ai që është i ngarkuar me një shërbim publik, s'ka nevojë të ketë mençuri dhe zotësi të jashtëzakonshme për të bërë që publiku të përfitojë nga shërbimi i tij. Dëshira dhe këmbëngulja mund të kryejnë punë që nuk mund t'i kryejë mençuria dhe zotësia.

Rreptësia e përdorur në edukim, shtyp shpirtërisht njeriun që edukohet.

Virtytet forcohen nga të mirat që kanë sjellë.

Besimi tek njëri-tjetri është hallka e besimit të ndërsjelltë, që farkëton besëlidhjen e një populli.

Gjaku i njerëzve është prodhim i atdheut të tyre, prandaj është e drejtë e atdheut të tyre.

Secili është i detyruar t'i shërbejë atdheut të tij pa shpërblim. Nuk është për t'u qortuar ai që i shërben atdheut të tij dhe shpërblehet, por s'ka poshtërsi më të madhe se të rrezikosh atdheun për interesa personale.

Njerëzit e shkencës janë vëllezër edhe sikur t'u përkasin dy kombeve armiq.

Arsimi dhe qytetërimi largojnë armiqësitë midis kombeve. Kombet e qytetëruara e çmojnë edhe meritën e kombeve të tjera. Kombet e egra, njerëzit që nuk janë të kombësisë së tyre i shikojnë si shtazë ose si egërsira.

Detyrat njerëzore janë një barrë e rëndë. Sjellja e keqe është një moçal i madh. Për të nxjerrë në breg këtë barrë nga një moçal i tillë, duhet të ecësh drejt pa shikuar në të djathtë dhe në të majtë.

Morali i mirë është lumturia më e vërtetë dhe më e qëndrueshme në këtë botë. Njeriu me moral të lartë është i lumtur në çdo çast, ndërsa njeriu me moral të ulët dhe me vese kurrë nuk shpëton nga fatkeqësia.

Kombi i përngjan anijes: Ligji është në vend të timonit, opinionin publik janë velat, ndërsa liria është në vend të erës. Sikundër timoni nuk hyn në punë pa velat, edhe



Gjuha shqipe

ligji në këtë rast nuk sjell asnjë dobi. Velat, nën forcën e erës, e shkatërrojnë anijen pa timon. Po kështu, opinionin publik dhe ligji, në kushtet e një lirie të tepruar, shkaktojnë zhdukjen e kombit. Sikundër nuk mund të lëvizë nga vendi anija që i ka në rregull velat dhe timonin, por i mungon era, edhe kombi që i ka të përsosura ligjet dhe opinionin publik, nuk mund të përparojë pa liri. Qeverisja e vetes është më e vështirë se qeverisja e të tjerëve.

Lumturia është një bimë që rritet vetëm në vazon e përmbytjes së ambicjeve dhe të prirjeve ekstravagante.

Moszbatimi i një ligji mund të shkaktojë një prishje të përkohshme të rregullit që mund të ndreqet, por mungesa e një ligji mund të shembë nga themelet një shtet të tërë.

Ditura e moralit është më e nevojshme nga të gjitha dituritë e tjera, por, fatkeqësisht, këtë dituri përpiqen ta nxënë pak njerëz.

Ata që përpiqen të arrijnë të drejtën, nuk mund ta kapin atë pa u rrëzuar disa herë. Këto krijesa të dashura, pasi e mësojnë se mundimi për të arritur të drejtën kalon nga vendet më të pakalueshme dhe e ndryshon rrugën një mijë herë, duhet të kuptojnë sakrificën e rrugëtimit lumturak.

Njeriu nuk duhet të lejojë hyrjen pa kontroll dhe pa hetim të çdo mendimi dhe ëndërrimi që rri në radhë te porta e mendjes së tij.

Sikundër bimët e hidhura që janë të dobishme në mjekësi, edhe mjekimet e hidhura janë të dobishme në fushën e moralit.

Sevasti Qiriaz për Naim Frashërin

Shënim: Të mësuarit e recituarit e një pjese nga Sevasti " nga një anë ngjall kureshtjen për këtë figurë të rilindjes, nga ana tjetër forcon koherencën Rilindjes Kombëtare në mendjen e nxënësit.

Para se të afronemi, disa nga këta më heqin vërejtjen, po më tepër një njeri, i cili ndonëse qe me shtat të mesmë dhe i imët, kishte fytyrë fortë të qetë dhe tërheqëse. – Si u përshëndosmë me të gjithë, Naimi më afëronet dhe pasi më përshëndoshi edhe një herë, më thotë këto fjalë, të cilat edhe janë të gjalla në zemrën t'ime. Fjalë që tronditnë shpirtin e të gjithëve atyre që e dëgjuanë. Fjalë plot entuziazmë; dhe flakë që derdheshin prej një zëmre plot ideale të nalta.

“Motër, punë më të mirë dhe më të vyerë nuk mund të bësh për Shqipërinë përveç asaj që keni ndërmend të bëni bashkë me vëllanë tuaj dhe mikun tim të dashur. Po unë dua të shtonj vetëm dy fjalë; paskëtaj nisi detyrat e tua më të mëdhatë dhe në qofsh besnike ke për të bërë më të mëdhatë vepra për atdhenë. Pengime dhe turbullime shumë, edhe të mëdha, do të keni në këtë udhë që po jeni nisë, por si trimë shqipëtarë i ke për t'i kapërxyerë të gjitha. Të gjithë do të vinë nënë hijen tënde, i frymëzo me ideale të lartë e të vërteta që të harrijnë një arësim të vërtetë dhe kështu ta bëjnë brezin tonë të pushtojnë ata virtyta që ta bëjnë gati që të çpëtojnë kombin nga padija dhe ta ngrenë dhe lartësojnë atë”

Këshillat e tija të vlefshme më bënë, si thashë edhe më sipër, një përshtypje të thellë dhe më kanë qenë krahe që kur se hyra në fushën kombëtare.

Kombi shqiptar kurrë do të mos harronjë veprat e këtij biri të math si edhe të shokëve të tij. Ndë mos paçin gjer më sot përmendëtoje prej numëri, kanë nga një përmendëtoje në zëmër të çdo atdhetari.

Naim Frashëri kish atë fuqi që të frymëzonjë idealat e tija të tjerëvet dhe i bënte të kuptojnë detyrat e tyre kundrejt atdheut. Shpirti i madh është gjithmonë ay që mbretëron.

Punën e tyre na e dorëzuan që ta bëjmë me një mënyrë tjetër, por jo kurrë me tjetër shpirt, por me atë shpirt si të tyren.



Gjuha shqipe



Kujtime nga ceremonia e diplomimit në Robert College, Stamboll, ku i pranishëm ishte Naim Frashëri



RITI I LUTJES DHE I IDENTIFIKIMIT TË BUJARIT SHQIPTAR

Shënim: Nëse dikush do të paraqitet në konkurs me këto lutje të rilindasve, duhet të sigurojë karakterin reflektiv që ka lutja. Mundet që gjatë recitimit t'i mbajë duart në formë shqiponje, por qëndrimi duhet të jetë reflektues dhe jo deklamues apo argëtues, siç e shohim shpesh, dhe që ndryshon nga origjinali që ka qenë reflektiv. Konkretisht: duart mbahen si shqiponjë, por janë të vendosur si kapakë libri në atë mënyrë që ngjan sikur fëmija po e lexon librin, pra me duar si shqiponjë por edhe si një libër i hapur, pra pjesa e brendshme e pëllëmbëve .

Ky rit u krijua për herë të parë në librin “Besa, feja ime, e fëmijëve të mi dhe e bujarëve shqiptarë” (Libri i Shenjtë) me autor Artur Shkurti, në vitin 2009. Libri synon të bëjë realitet devizën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare “Besa e shqiptarit është shqiptaria” (Pashko Vasa). Në faqen 32 të këtij libri është Riti i Lutjes së Bujarit Shqiptar, në të cilin skicohet qëndrimi që merr dikush që thotë lutje të poetëve shqiptarë. Frymëzimi u mor nga vargjet e Naim Frashërit:

*“Me zëmrë shumë të qetë
lith duartë në kraharuar,
pa thotë: “Zot i vërtetë!
emri yt qoft’i lëvduar!”*

Në faqen tjetër, keni lutjet pjesë e programit.



Nëse fëmijët e shkollave shqipe mësojnë modele të lutjeve nga Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Lasgush Poradeci, Pashko Vasa, Ali Asllani e të tjerë autorë do të kuptojnë më shumë se është e mundshme që ata të ndajnë ndjesitë e tyre kombëtare edhe në këtë mënyrë që thellësisht ndikon psikologjinë e tyre. Mund të përfitojmë nga ky vëzhgim i Gonxhe Bojaxhiut që thotë:

“Familja, që lutet së bashku, mbetet tok.

*Fryt i lutjes është besimi, fryt i besimit është dashuria,
fryt i dashurisë është shërbimi i ndërsjelltë ...”*

Shkollat shqipe i japin këtë kuptim shqiptar fjalës së Gonxhe Bojaxhiut: *mbetemi tok si komb, bëjmë fenë tonë (Besën), si të kemi besim më të madh e të shprehur, do të kemi një dashuri më të madhe për njëri-tjetrin si shqiptarë dhe do t'i shërbejmë njëri-tjetrit. Nuk ka të bëjë ky kontekst me ndonjë konvertim fetar, por thjesht është një edukim patriotik duke u udhëzuar nga rilindasit.*





Falna, Zot, i math ne njerëzinë,
Edhe të mirat' e dashurinë,
Vëllazërinë, zemrën' e qëruar,
Mëndjenë pa faj, shpirt të uruar,
Bëna të drejtë në këtë jetë,
T'urt'e të mirë dhe të vërtetë.

Naim Frashëri

Nemi ato vite t'arta
që zemra i humbi shqimit,
nem ato ide të larta,
që feja i sjell njerëzimit.
Nem' t'ëmbelat ndiesi,
nëm dashurinë tënde t'dëllirë,
nëm ndjenjat pa kufi
të zemrës sate aq të mirë;

Pashko Vasa



O Zot i lum, qi vetem n'dorë Ti i ke
Shartet e popujve e mbretnive t'tana,
E gja pa hiri kurr Ty s't'ndodhë mbi dhe,
As nalt mbi qiellë, ku shndrisin dielli e hana,
Deh! Ti, i Pushtetshëm heret si ne e vona,
Shih e gjyko mbi gjith kto kobet t'ona.

Po, po; Ti sod, o gurra e dashtnis shejte,
Lshoj fashë zemrat e njerzvet,
Vllaznoj popuj e mbreten,
E ban qi paqa vrik t'na ngushllojë jeten;
Pse bota mbarë, atëherë, kah len e kah merr dielli
ka me t'lavdue me t'ambla jone t'reja,
E ma e kerthnesët ka me lulzue prap Feja.

Gjergj Fishta



Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithëmon'armiqtë e tij!
Gaz përjetë paçin zotërit e tij!

Naim Frashëri

Të lus, o Lajmës qielluar!
O Frym' e Zotit, Vetë Zot!
Me hirin t'ënd të pashteruar
Që ka mburim përjetësije,
Hirplot, o Shpirt, nër gaze Ti-je.
Dhe nër mjerime je hirplot!

Lasgush Poradeci



Programi i kthimit në atdhe i shkollës shqipe

Shkolla shqipe duhet ta ketë për objektiv programin e kthimit në atdhe. Kjo gjë nuk varet nga objektivat e prindërve dhe të nxënësve konkretë. Për shumë arsye ata nuk mund të kthehen, por shkolla bën punë të vazhdueshme për kthimin. Kthimi nuk është fare i lehtë. Ai del po aq i vështirë sa është edhe largimi nga atdheu. Ashtu si prindërit janë përgatitur me vite për t'u larguar, edhe tani duhet të përgatiten me vite për t'u kthyer. Për t'u larguar u është dashur të mësojnë anglishten, gjermanishten, italishten etj. Tani për t'u kthyer duhet t'u mësojnë fëmijëve gjuhën shqipe, duhet të përgatiten kulturalisht për kthimin. Këtu shkolla shqipe do të gjejë veten, detyrat e saj.

Duke hartuar programin e kthimit në atdhe shkolla shqipe bashkohet me objektivat kombëtarë. Shkolla ofron ndihmën e saj kulturore dhe bashkëpunimin e saj që familjet të bëhen të vetëdijshme, që komuniteti të ndihmojë e të bëjë mbarë një familje apo grup familjesh që të kthehen. Duhet të ndihmojnë të gjithë dhe të tërheqin njëri-tjetrin drejt atdheut.

Shumë shpejt shkollat shqipe do të kenë modele të programeve të kthimit.

Pjesë kryesore e programit të kthimit është frymëzimi kombëtar. Kjo është një punë e hollë, dhe e gjerë që i kërkon shkollës shumë mësim, veprimtari, projekte, biblioteka, komunikim e bashkëpunim të gjithanshme. Arsyet për largim të njerëzve nga Shqipëria kanë qenë të shumta, por më të mëdha do të jenë tani arsyet për kthim në atdhe. Kthimi do ta përmirësojë jetën shqiptare, sepse të kthyerit do ta bëjnë punën e tyre me më shumë dituri e profesionalizëm, dhe me më shumë dashuri, e cila mund të mos kuptohet nga vendasit që nuk kanë lëvizur ndonjëherë nga vendi për një periudhë të gjatë. Është e qartë se tjetër është turizmi e tjetër është emigracioni.

Pikë kyçe e suksesit të shkollave shqipe do të jetë forcimi i fiseve shqiptare të cilat janë shkërmoqur duke u shpërndarë, ndaj kthimin do ta quajë se është një objektiv fisnor. Askush nuk kthehet nëse kupton që të gjithë fisin e ka jashtë atdheut dhe nuk ka kush e pret në Shqipëri.

Shumë shpejt shkollat shqipe me programet e tyre të kthimit në atdhe do të vendosin nën stres organet lokale e qendrore në Shqipëri, por ky do të jetë stres pozitiv, sepse rezultati do të jetë me përfitim të madh kombëtar.

Ekzistenca e programit të kthimit kthehet në një mbështetje të fuqishme psikologjike që shkolla shqipe bashkë me komunitetin u bën anëtarëve të saj, që vazhdimisht do të jenë në tundimin "të kthehen apo jo".



Gjuha shqipe

Flamuri kombtar nuk ka shka ban nder ne,
Po kje se dashtuni nuk kem p'r Atdhel
Gjergj Fishta

Shkolla Shqipe si Faltore e Bujarëve Shqiptarë

Shkolla shqipe jashtë atdheut tregon kujdes në çështjen fetare. Jashtë atdheut faltoret janë kryesisht të huaja dhe ndiqen nga grupe mikse të kulturave të ndryshme. Shpesh bëhet problem për prindërit të ndjekin një shkollë shqipe, nëse kuptojnë që drejtuesit e saj anojnë nga një besim i caktuar fetar.

Në këtë pikë shkolla shqipe duhet të jetë e përgatitur t'u edukojë nxënësve çështjen fetare shqiptare dhe ta bëjë këtë hapur sipas devizës së Rilindjes Kombëtare "Besa e shqiptarit është shqiptaria" (Pashko Vasa).

- për libër të shenjtë** le të jetë përmbledhja e frymëzimeve të poetëve të Rilindjes (një pjesë e keni këtu),
- për profet** të kenë Naim Frashërin (sipas Lasgush Poradecit dhe thujse të gjithë poetëve shqiptarë, por edhe të publikut të gjerë), për figura të tjera hyjnore afërsisht me të njëjtin status si të Naimit, le të jenë Pashko Vasa, Lasgush Poradeci, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Mitrush Kuteli. Naimi është simbolikisht në krye, por duhet ditur që rilindasit punojnë në grup dhe skemën e punës në grup e jep Lasgush Poradeci në "Misioni i shqiptarëve të Bukureshtit dhe Naim Frashëri" (1946).
- për **rite të besës** le të kenë ritet e nderimit të datave dhe figurave kombëtare, dhe
- për **identifikim**, le të identifikohen si "bujarë shqiptarë" që ndjekin "besën"
- për **faltore të bujarëve shqiptarë** të kenë shkollën shqipe apo shoqatat patriotike shqiptare ku ata edukohen
- për **simbolikë identifikuese** le të kenë duart si shqiponjë

Nuk është me shumë rëndësi që t'i kushtohet rëndësi anës formale (pra referimit në termat "besim" apo fjalës "fetar"), por prindërit, fëmijët e komuniteti shqiptar duhet ta dinë se shkolla shqipe ua mbulon këtë nevojë fetare në mënyrën më të bukur, më të shëndetshme, më funksionale dhe shqiptare, pra u jep orientim në bazë të ideve të Rilindjes Kombëtare. Nëse për ta ka rëndësi misioni i shkollës shqipe, ata duhet ta pranojnë këtë pozicionim të shkollave shqipe dhe ta quajnë si fatin më të madh që mund t'u ndodh fëmijëve të tyre. Orientimi universal pastaj në faltore të tjera është një këndvështrim tjetër që sigurisht ka vlerën e vet, sidoms në respektimin e traditës së shtetit ku vepron shkolla shqipe.

Ky koncept i shkollës shqipe i kënaq të gjithë shqiptarët. Familjet pra i dorëzohen konceptit përbashkues të rilindasve dhe aq u del e u tepron edhe për orientim fetar. Ky forcim ideologjik shqiptar, do t'i bëjë fëmijët mjaft të fuqishëm nga ana ideore. Çdo botëkuptim fetar ka nevojë për traditën kombëtare dhe nxënësit shqiptar në cilëndo faltore do të rrezatojnë të njëjtën qasje që shkolla shqipe u mëson, qofshin këta fëmijë të traditës së krishterë apo muslimane, do të dinë t'i përgjigjen pyetjes kyçe "Si ia arrini ju shqiptarët të keni harmoni fetare?". Sot për sot, as në Shqipëri, nuk dihet mirë se si t'i përgjigjesh kësaj pyetje, që tregon një mospërgatitje të shkollave dhe të brezit të ri, gjë që cënon rëndë të ardhmen e tyre në çështjen fetare, sepse mund të bihen pre e skemave konvertuese nga një fe në tjetrën.

Shkolla natyrisht respekton drejtimin fetar tradicional të çdo familjeje dhe familjet po ashtu e kuptojnë shkollën shqipe në ato që u mëson fëmijëve dhe në ndjesitë që ajo edukon.



MËSUESIT SHQIPTARË figura qëndrore të komunitetit dhe financimi i shkollave

Që shkolla shqipe të ketë sukses, duhet të jenë mësuesit në krye të komuniteteve. Mësuesi shqiptar që ka edhe licensimin e shtetit ku vepron shkolla duhet të jetë qëndror për një shkollë shqipe. Ai/Ajo duke qenë i ditur për procedurat, programet, ligjet, programet, veprimtaritë vendore do të ketë më shumë mundësi të drejtojë si duhet nxënësit shqiptarë. Nëse familja do të ketë sukses me programin e kthimit në atdhe si një program shumë i lartë, mësuesi shqiptar i shkollës shqipe kthehet në frymëzuesin kryesor të fëmijës dhe e përgatit atë sipas interesit konkret që prindërit deklarojnë.

Nga ana tjetër, mësuesit janë profesionistët e duhur për të ndërtuar komunitete të pastra shqiptarësh në harmoni me pjesën vendase, larg nga dukuritë negative. Vetë shteti i huaj ka më shumë besim në shoqata që drejtohen nga mësues që vetë ai i ka licensuar, ndaj çdo shoqatë vendore duhet t'i ketë mësuesit në krye.

Të gjithë duhet të ndihmojnë mësuesit shqiptarë. Problemi i madh i shoqatave shqiptare është se ato duke dashur të jenë “me dyer të hapura për të gjithë” rezultojnë të kenë një reduktim të madh dhe praktikisht nuk bëjnë asgjë. Problemi i madh i emigracionit është gjuha dhe trashëgimia kulturore dhe për gjuhë dhe kulturë duhet të jenë mësuesit në krye. Synimi kryesor janë fëmijët dhe trashëgimia kulturore. Ndërkohë që fokusi është tek gjuha dhe kultura, mësuesit shqiptarë do të japin edhe një mbështetje të fuqishme psikologjike dhe në edukimin e tipareve të personalitetit. Ata do të bashkëpunojnë në emër të prindërve me shkollat ku ndodhen fëmijët, do të monitorojnë punën e tyre, do të trainojnë prindërit për të shmangur dukuritë negative.



Gjuha shqipe

FINANCIMI I SHKOLLAVE SHQIPE

Nëse prindërit e shohin problemin kështu, pra e shohin kështu rolin e mësuesit, kuptohet që duhet të përgatiten që t'i mbajnë mirë mësuesit shqiptarë dhe të investojnë tek ta.

Ekziston një video-regjistrim në youtube “Financimi nga buxheti familjar i gjuhës shqipe është interes kombëtar” (Artur Shkurti, 28 nëntor 2022).

Familjet shqiptare janë përfituese kryesore të shkollave shqipe dhe duhet të jenë edhe financueset kryesore. Ush jep fondet, ka edhe përparësinë që të ndikojë programet e edukimit. Komunitetet do të përfitojnë edhe nga oferta bujare e shteteve të tyre për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por nuk duhet ta quajnë të mjaftueshme.

Idea kryesore është që shkollat shqipe nuk mund të shpeshojnë vetëm në paratë që merren nga projektet dhe familjet duhet ta kuptojnë që me financimin e shkollave shqipe janë duke financuar në mënyrë të pavarur një institucion shqiptar. Nëse shkolla i merr paratë nga diku tjetër, është e sigurtë që do të bëjë programin e atij që jep paratë.

Komunitetet duhet të bëhen të afta të blejnë ndërtesë për shkollat shqipe apo për veprimtarinë e tyre. Shkolla shqipe ka nevojë për arshivë, për bibliotekë, për mjete mësimore, për muze dhe të gjitha këto duan ndërtesë. Nuk mundet të shpeshojnë vetëm në godina me qera.

KLASA 1



Ç`ke harruar, moj Valbonë?

Sot, kur shkonim për në shkollë,
pse u ktheve si veri?
Ç`ke harruar moj Valbonë,
ç`ke harruar në shtëpi?

Mos vallë stilolapsin,
a mos bojërat në kuti?
Ç`ke harruar, moj Valbonë,
që u ktheve si veri?

Thotë Valbona e gëzuar:
- Asnjë gjë s`kisha harruar,
por, kur ika, u nxitova,
gjyshen nuk e përqafova.

Kam një qengj që ha bar

Kam një qengj, që ha bar,
me një zile në qafë varë,
kam një qengj, një larosh,
që ma quajnë bukurosh.

Giçi – giçi, plot me gaz
unë e ndjell, ai vjen pas,
be-be-be blegërin,
vjen nga prapa e m`arrin.

E me brirë dap e dap,
do të më hedhë mu në trap,
po s`më hedh, se më ka shok,
prandaj lozim të dy tok.

PËRRALLËTARJA - Xhevahir Spahiu

S`do që s`do të bjerë qepalla,
s`më zë gjumi pa përralla;
pa arush, ujk e të tjerë
s`mbyllet syri që të flerë.

Asnjë zë s`ndihet në dhomë:
-Mami, mami, hë, tregomë!
Një përrallë për zonzjën dhelpër,
po s`desh dhelpëra, për një ketër.
- Kafshët, -thotë,- dhe fik dritën –
porsa panë gjahtarët, ikën...

- O moj mami, përralltare,
Çdo përrallë një dritare.
Ti kallzon, kallzon kaq bukur,
Në çdo fjalë rri një flutur.

Në çdo fjalë trokon kali,
vret e pret kuçedrën djali;
del qerosi mendjemprehtë
bukuroshen e merr vetë.

Ja, qepalla zë e ulet,
mami thotë diçka për lulet.
Mijëra lule, buzë një lumi...
Mua, trak më zuri gjumi.

KËNGA E ABETARES “Udha e shkronjave”®

Nga Xhevahir Spahiu

Abetare, abetare,
Sillma diellin në dritare!

Lehtë, lehtë e bukur, bukur,
Dora ime, sa e lumtur,
Hap një faqe kthen një fletë
Nëpër shkronja – bota vetë.

Rrjedh në fjalë plot kumbim,
Gjuhë e lashtë e vendit tim.

Me ty mendjen lartësoj,
Me ty zemrën e gëzoj,
Bëhem zog e fluturoj.

Abetare, abetare,
Ti je dielli në dritare.

STINËT

Me të shtatë ngjyrat,
mbi letrën e bardhë,
vizatoj natyrën
si piktor i rrallë.

Fushën gjelbëroj
dhe çel luleshqerrën,
kështu në mes tonë
unë sjell pranverën.

Gjithë kalamajtë
plazheve i mbledh,
zverdh grurin e artë
dhe verën e sjell.

Rrushin pjek në vreshta,
zogjtë larg i shpie
dhe, papritur, vjeshta
përmbi letër bie...

Erën vë të fryjë
edhe retë ikin,
ujin bëj të ngrijë
Dhe e kam sjellë ... dimrin.



Gjuha shqipe

Kaloi dimri, erdh` pranvera, me lulëzim
Erdh` lejleku, dallëndyshja, fluturim.
Rritet bari, vishet pylli, me blerim
Hapet zemra e fëmijëve, plot gëzim.

NËNA

Ti ke pak zjarrmi
vogëlushe Leonorë,
e nënës i digjet
zemra në kraharor.

Ndodh në mëngjes
s` të hahet – nuk ha,
urinë e tërë botës
nëna atë ditë ka ...

Oh, papandehur gishtin
e gërvishte pak,
E di ç` ndodh me nënën?
Zemra i pikon gjak!

Mbi shtrojen më t`butë
Ajo shpesh këlthet:
- Kam dro` ndonjë pupël
vashëzën mos ma vret.

KLASA 2

KU KEMI LERË

Andon Zako Çajupi

Në ç'vend kemi lerë?

Ku na bëjnë nderë?

Në Shqipëri.

Po njeriu vetë,
cilin do në jetë?

Do vendin e tij.

Ku mund të gëzojë

dhe me nder të rrojë?

Në Shqipëri.

PËRRALLA E KECËRVE

Dritëro Agolli

Udhës po shkonte ngadalë nëna dhi,
me kecërit e saj lozonjarë.

Po shkonte në librari

t'u blinte dy abetare...

I bleu abetaret dhia brigjatë,
dhe kecërit kërcenin e bënin shamatë.

-Do bëjma A, do të bëjmë Be,

hh, lumja ti, nënë, ç'kecër na ke!

E ëma detyra të lehta u vuri një ditë

dhe shkoi të fjalosej me dhitë:

Kur erdhi i gjeti kecërit në gjumë.

-Ah, përtacë, po kur qenki lodhur kaq shumë?

Ju s'paski mësuar fare!

Ç'i bëtë fletoret me gjithë abetare?

-E be-be-be! E me me me!

I hëngrëm fletoret me gjithë abece....



Gjuha shqipe

SHQIPONJA

Xhevahir Spahiu

Hape krahët, fluturove

thellë nëpër kaltërsi.

Udhëtove, udhëtove

çerdhen ku do ta bësh ti?

Ty asgjë s'ta mbushka syrin,

as kjo pemë, As ky gur.

Më në fund moj trimëreshë,

bëre çerdhe në flamur.

SA TË DUA, O SHQIPËRI

Asdreni

Sa të dua, o Shqipëri,

sa gaz ndiej e sa dëshirë.

Për ty gaz e dashuri

mu në zemër më ka mbirë!

Se për mua, o Atdhe,

je një lule aq e vyer,

sa nuk gjendet përmbi dhe

shpirtin tim për ta ushqyer!

DHELPRA DHE RRUSHTË

La Fonten

Dhelpra e mallkuar
doli nga shtëpia.
E kish marrë uria,
vate për të gjuar.
Sheh një pjergull me rrush plot,
bën t'i zerë e s'i ze dot.
Dhe si s'mundi dot t'i zerë
Tha: «Qenkan rrush të pabërë.
S'janë, jo, s'janë për mua.
Nuk i dua, nuk i dua,
Le t'i hajë ndonjë tjetër».
Ç'mund të thoshte zonja dhelprë?

BALOJA

Spiro Çomorra

-Pa më thua, Balo xhan,
që rri tok me dhen në stan,
natën kur si çiliminjtë
i merr gjumi bagëtitë
dhe ujqit me vrap vijnë
që nga larg e ulërijnë;
çfarë bën, o Balo, ti?

Gjithë natën rri e ruaj ...
dhe kur vjen ndonjë i huaj
grabitqar e zemërlig,
s'trembem kurrë në rrezik...

-Si trimosh unë vërvitem
dhe me ujqit kacafitem,
gjersa të ikin të tmerruar,
o të ngordhin të copëtuat ...
-Balo, Balo, çdo çoban,
të ka mik e të ka xhan!

GJUHA JONË

Naim Frashëri

Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël! Sa e gjerë!
Sa e lehtë! Sa e lirë!
Sa e bukur! Sa e vlerë!



Gjuha shqipe

DORË, MOJ, E VOGLA DORË

Adelina Mamaqi

Dorë, moj, e vogla dorë,
je e pastër si dëborë.
Më lan faqe, më lan gushë,
më mbledh lulkëza në fushë.
Ti më vesh e ti më kreh,
shtron tryezën, pjata ve.
Duar, o të vogla duar,
kur ju shoh duke punuar,
seç më ndizen faqet flakë
më rreh zemra tik e tak,
Cicëroj si zog gazmor:
“Lum kush është punëtor”.

QUKAPIK, O QUKAPIK!

Adelina Mamaqi

- Qukapik, o qukapik,
të kam shok e të kam mik.
Pik-pik-pik! Ç'po bën kështu?
- Gëlltis krimba dru më dru.

Krimbin unë e kam armik,
sepse është shumë i lig,
se ha gjethe e lëkurë
nëpër lule, nëpër drurë.

- Qukapik, o qukapik,
ç'i bën krimbat, more mik?
I çukis unë pik, pik, pik,
ndaj më quajnë qukapik.

KLASA 3

Librat rrinë rradhë rradhë

Xhevahir Spahiu

Librat rrinë rradhë - rradhë,
presin dorën që t'i marrë.

Presin dorën t'i shfletojë,
presin syrin t'i lexojë.

Sa përralla rrinë aty;
eja t'i këndojmë të dy!
Sa figura, sa tregime,
duan të hyjnë në botën time.

Librat rrinë krah për krah;
cili rradhën sonte ka?

Thotë i pari: merrmë mua;
siç më do dhe unë të dua.

Flet i dyti poshtë në xham:
po unë rradhën kur e kam?

Librat rrinë rradhë - rradhë,
presin dorën që t'i marrë ...

Erdhi prilli, ç'u shkri bora

Himariote

Erdhi prilli, ç'u shkri bora majave.
Mbani vesh, bije këmbora, majave.
O pranvera, vera-vera, sa gëzim,
këndojn zogjtë nëpër ferra, pa pushim.
Gjithë natyra ç'u ndryshua, dhe ndryshon.
Gjithë toka zbukuruar, lulëzon.

Zogjtë dy nga dy jetojnë, në fole.
Çaj në qiellin e shkojnë, si rrufe.



Gjuha shqipe

Përralltarja

Xhevahir Spahiu

S'do që s'do të bjerë qepalla,
s'më zë gjumi pa përralla;
pa arush, ujk e të tjerë
s'mbyllet syri që të flerë.

Asnjë zë s'ndihet në dhomë:
- Mami, mami, he, tregomë!
Një përrallë për zonjën dhelpër,
po s'desh dhelpëra, për një ketër.

- Kafshët, - thotë, - (dhe fik dritën) -
porsa panë gjahtarët, ikën ...

- O moj mami, përralltare,
Çdo përrallë një dritare.
Ti kallzon, kallzon kaq bukur,
Në çdo fjalë rri një flutur.

Në çdo fjalë trokon kali,
vret e prët kuçedrën djali;
del qerosi mendjemprehtë
bukuroshen e merr vetë.

Ja qepalla zë e ulet,
mami thotë diçka për lulet.
Mijëra lule buzë një lumi...
Mua, trak, më zuri gjumi.

Mëmëdheu

Çajupi

Mëmëdhe quhet toka
Ku më ka rënurë koka,
Ku kam dashur mëm' e atë,
Ku më njeh dhe gur' i thatë,
Ku jam rritur me thërrime,
Ku kam folur gjuhën time,
Ku kam fis e ku kam farë,
Ku kam qeshur, ku kam qarë,
Ku rroj me gas e me shpresë,
Ku kam dëshirë të vdesë.

Tarja nuk e lan fytyrën...

Dionis Bubani

Tares mjalti i pëlqen,
e shijon edhe yndyrën,
por, pas buke, kohë s'gjen,
kurrë nuk e lan fytyrën.

Pasi shqepet me ushqim,
del në rrugë i palarë,
i flet nëna pa pushim,
por më kot, avazi i parë!

Gjithmonë bërtet mamaja,
le të lodhet ajo kot...
... Taren na e zu belaja,
se e ndoqën grenxa plot.

U pendua "trimi" Tare,
kur pa grenxat mizëri...
Po ato s'iu ndanë fare,
e pickuan mirë e mirë,
sa u ënjt, u bë fuçi!



Gjuha shqipe

Vizitë në muzeun arkeologjik

Xhevahir Spahiu

Ciceron, na merr përdore,
udhët na trego;
shekuj, armë dhe stërgjyshër
ti nga gjumi, zgjo!

Te kjo enë e vogël balte
një e fshehtë rri;
te kjo thikë e hershme guri
rron një histori.

Shih sa bukur mozaiku,
art të madh zbulon!
Kokës së një luftëtari
trupi i mungon.

Kur të dalin në na pyetshin,
ku ishim dhe ç'pamë,
- Folëm ilirisht, - do t'themi, -
me stërgjyshërit tanë.



BUKA

Dritëro Agolli

Të duket gjë e zakonshme: jap pare, marr bukë!
Po ne e pritëm kaq shumë!
E mbollëm, e korrëm e djersët na vanë çurkë,
Pastaj e shimë në lëmë e mbetëm pa gjumë;
I mbushëm thasët dhe ecëm në pluhur e në gurë,
Mullirit e bluam dhe e vumë në magje,
Në krahë e morëm dhe e shpumë në furrë,
Pastaj rrodhi në sofër nga korja e ngrohtë një paqe ...
Të duket një gjë e zakonshme?

Ekskursioni dhe aspirina

Dionis Bubani

Ikën shokët n'ekskursion,
Gimi, strukur pranë zjarrit,
i kënaqur po mendon:
- Besa, sot i rashë qarit!

Është natë... Kushedi
se sa larg do të kenë shkuar,
una mbeta në shtëpi,
u tregova më i zgjuar.

Po më ranë fort havale,
do t'u them troç se ç'mendoj:
"Mund të ftohesh nëpër male,
unë dua të jetoj!"

Ja, kështu mendonte, por
doli Gimi i djersitur
që nga soba, në oborr,
dhe u plevitos papritur...

Kur u kthyen gaz e jetë,
nga ato kreshta dhe lëndina,
shokët Gimin na e gjetën
duke pirë aspirina!

FËMIJA

Ndre Mjeda

E kandshme asht hana
Kur del me zana,
E n'tokë me dritë përndaret.
Hyjzit që shndrisin
E që shëtisin
Npër qiell, janë t'bukur faret.
Kur del agimi
E rruzullimi
Me 'j dritë kuqloshe mbëlohet,
E përmbi kashta
Shndrit pika lashta,
Zemra me mall gazmohet.
Asht i madh shendi,
Kur ndihet shpendi
Ndër pyje tuj pingrue;
E knaqshme a'j lule
Kur ju përkule,
O flad i let, me e lmue.
Por s'i giet qielli,
Nuk i giet prilli
As flad që shëtit lulet
E me erna veshet,
Foshnjës që i qeshet,
Nanës kur mbi të përkulet.

ATDHEU

Ali Asllani

Sa të rroj e sa të jetë,
Gjiri i qiellit plot me yje,
Ty shqiptari do të ketë,
Si ka diellin përmbi krye;
Si ka diellin si ka hënën,
Mu si nëna që ka djalën,
Mu si burri që ka fjalën.

Un', im at' e gjysh stërgjysh
e di bota si dhe qysh,
cilin kemi më të shenjtë,
shum të dashur e të shtrenjtë,
dhe për cilin bëjmë be,
be për qiell e be për dhe,
be për tokën kombëtare,
dhe për ty, moj tok' bujare.



Gjuha shqipe

SHQIPËRI, O JETË GJATË

Naim Frashëri

Shqipëri, o jetëgjatë!
Ty të kemi mëm'e atë,
Dhe për ty do të luftojmë,
Gjersa të të trashëgojmë.
Për ty gjithë dit' e natë
Mejtohemi gjër' e gjatë.

KLASA 4

SHQIPËRI, O JETËGJATË!

Naim Frashëri

Shqipëri, o jetëgjatë,
ty të kemi mëmë e atë
dhe për ty do të luftojmë
gjersa të të trashëgojmë.
Për ty të gjithë, ditë dhe natë,
mendohe mi gjerë e gjatë,
ti kurrë s'prishesh, s'shkretohesh,
as drobitesh, as rrëgjohesh,
më ke gjithë bukuritë
e të tëra mirësitë,
ke fusha me lule shumë,
lumenj të mëdhenj pa gjumë,
male të lart' e të veshur,
buzën e detit të qeshur.
Më je dritëzë në dritë
me të gjitha mirësitë.

HARABELI

Dritëro Agolli

Dhe shpezët shtegtarë fluturuan
me shtërg e dallëndyshe - gjithë ç'qe-në,
Veç harabeli vendit nuk po luan,
ai nuk ia beson kurrkujt folenë.
Livadheve të korrur fluturon,
me sqep në bar çepkat e vërshëllen
dhe duket se me shokët kuvendon,
dhe duket se diçka përreth s'e gjen.
Dhe sytë e vegjël hedh përmbi zabel,
vështron se si mërgohet shpezëria,
por s'di të thotë zogu-harabel:
"Të çmendur, ju
pse ikni nga shtëpia?"



SHQYPNIA

Gjergj Fishta

Edhe hana do ta dije.
edhe dielli do t'ket pa,
se përqark ksaj rrokullie,
si Shqipnia 'i vend nuk ka!
Atje lejnë, po, tosk e gegë,
si dy rreze n'flakë t'nji diellit,
si dy rrfë, qi shkojnë tuj djegë,
kuer shkrep reja prej qiellit



KUJTOJ MËSUESIN

Agim Vinca

Pat ikur mësuesi im në Turqi,
unë abetaren e laga me lot,
në zemër më hyri fytyra e tij
dhe s'më hiqet as sot.

I vogël isha atëherë, pak dija,
jeta më dukej lojë e dëfrim,
po ngado që shkoja, kudo që vija,
shihja fytyrën e mësuesit tim.

Dëgjoja zërin e tij të dashur,
kur binte zilja për në mësim,
dëgjoja zërin e tij të dridhur:
"E di ç'është mërgimi ti, Agim?"

Por unë s'e dija, s'kuptoja dot,
ç'ishte mërgimi dhe Anadulli,
Sytë e mësuesit ishin me lot,
atë ditë që fshati e përcolli.

Kaluan ditë, kaluan vjet,
librin nga dora s'e lëshova,
në banka të shkollës edhe në jetë,
punët e kësaj toke mësova.

Mësova unë se ç'ishte mërgimi,
shtëpia pa plang, sofrë pa bukë,
mësova pse mësuesi im
na la dhe mori të largëtën rrugë.

Sot, kur dhe vetë me ditar,
dal përpara nxënësve të mi.
e kujtoj mësuesin tim të parë,
arratisur larg në Turqi.



Gjuha shqipe

JEMI VETËM SHQIPËTARË

Naim Frashëri

Gjithë ç'jemi Shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Kemi të tërë një shpresë,
Një gjak, një gjuhë, një besë.
S'jemi grekër, as bullgarë
as gjë tjetër nuk jemi
jemi vetëm shqipëtarë
ne kët' emër nder e kemi.
Ky emr' është shum'i mirë
Se më s'jemi të gënjyer,
Nukë jemi n'errësirë,
E njohëmë gjën' e vyer.
Perëndija na e lëntë
Përjetë ta trashëgojmë
Edhe kurrë mos e dhëntë
T'a humbim a ta harrojmë!
Të lëmë mëmën tënë
E të marrim një shtrigë,
Zoti mos e pastë thënë!
Pun' e keq' e shum' e ligë.

PËRTACI

Mark Krasniqi

Një njeri përtac s'punonte aspak.
Puna më e vogël i bëhej farmak.
Njëherë s'kish ushqim, bukë s'i jepnin tjetër,
shkoi pra në fushë, te një dardhë e vjetër.
Dardha kishte kokrra, të mëdha gërcak,
të ëmbla sheqer, pjekur për merak.
Po përtaci ishte njeri për çudi:
përtoi t'i shkundte, në hije u shtri.
Hoqi dhe kapelën, pranë vetes e la,
"Bini këtu brenda, o ju dardha!" - tha.
Priste kokrra dardhe nga degët e saja,
kur një dardhë e madhe u shkëput nga maja
dhe përtacit tonë në hundë i ra,
thirri fort përtaci: "Obobo, ç'hata!" .

FJALA ËSHTË E VOGËL SHUMË

Odhise Grillo

Fjala është e vogël shumë:
disa shkronja, disa rrokje ...
Ajo rrjedh si mjaltë e qumësht
midis miqve, midis shokëve.
Fjala është e vogël shumë:
dhe e ashpër, dhe e brishtë ...
I ngre valët perçeshkumë,
kur vërsulet mbi armiqtë.
Fjala është e vogël shumë:
t'ëmbëlson a vret si plumbi...
Fjala është si një urë
që lidh brigjet e një lumi.



VJESHTA

Xhevahir Spahiu

Kur vjeshtës vendin i lë vera
dhe zogjtë shtegtojnë larg e larg,
nga pemët gjethet rrëzon era
si fjongo të arta përmbi park.
Kur vjeshta vjen, zverdhon në vreshta
bistoku i rrushit bukuri!
Me begatinë që sjell vjeshta
gëzohem unë, gëzohesh ti.
O vjeshtë e artë, o stinë e zjarrtë!
Ti, mrekulli e punës sonë!
Nga fryti yt i begatë
njeriut faqet i kuqojnë.



KLASA 5

TI, SHQIPËRI, MË JEP NDER!

Naim Frashëri

O malet, e Shqipërisë dhe ju, o lisat e gjatë,
fushat e gjëra me lule, që ju kam ndër mend ditë e
natë.

Ju bregore bukuroshe dhe ju, lumenj të kulluar,
çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar!

Do të këndoj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mendjen ma dëfreni ...

Ti, Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqiptar,
zemrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr!

DY PISHA - Dritëro Agolli

Një pish' e shtrembër në përrua
I tha një pishë krahë-gjatë:

- Sa keq, moj motër, më vjen mua,
Që je e madhe dhe e lartë!

- Po pse? e pyeti pish' e drejtë.

- Po ja, kur shkrep në qiell rufe,

Kur sipër malesh nxihen retë,
Të djeg të parën ty mbi dhe,
Se trupi yt i gjat' i gjatë

Në sy të botës bije
- E kam nder - e gjata thotë -
Që shkrep tima të më bjerë,

Po të mos fshihem nëpër botë
Si ti, krijes' e mjerë!



Gjuha shqipe

GJUHA SHQIPE

Ndre Mjeda

Përmbi za që lëshon bylbyli
Gjuha shqype m'shungullon;
Përmbi erë që nep zymbyli
Pa da zemrën ma ngushllon.

Ndër komb tjerë, ndër dhena tjera
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera
E prej mallit derdhi lot.

Nji kto gjuhë që jam tuj ndie
Janë të bukra me themel;
Por prap kjo, si diell pa hije
Për me t'tanave ju del.

Por gazmo ndër gjith'kto t'vështira
Përse ende s'sharrove krejt;
Diçka t'mbet ndër ato t'mira
Mbas dy mij' e ma shum vjet.

Geg' e Toskë, Malci jallia
Jan' nji komb, m'u da s'duron:
Fund e majë nji a Shqypnia,
E nji gjuhë t'gjith' na bashkon.

Kjoft mallkue kush qet ngatrrime
Ndër kta vllazën shoq me shoq:
Kush e dan me fjal' e shkrime
Ça natyra vetë përpoq.



MIUT TË FUSHËS QË IA PRISHA FOLENË

Robert Burns (poet skocez)

Përktheu Dritëro Agolli

Ti, kafshë e vogël qimendritur,
Ku shkon me vrap e lebetitur,
Pse dridhesh në ethe e sflitur,
Për fatin tënd?

Mbi ty lopatën s'e kam ngritur
Dhe mos u tremb!

Ti vjedh, megjithëse s'mbjell dhe s'korr,

Kërkon të rrosh, ndaj s'je fajtor;
Modest në vjedhje, s'vjedh si horr,
Veç bren një thelb;

Ndaj ti, miush, s'më varfëron
Kur ha pak elb!

Pa strehë e vatër sot të lashë,
Padashur frikë e tmerr të dhashë
Dhe s'do të gjesh as bar, as kashtë
Të ngresh shtëpi,

Po fillikat do gdhihesh jashtë
Në borë e shi.

MALL PËR ATDHE

Hajnrih Lojtholt (Poet zviceran)

Përktheu Petraq Kolevica

Ju, male të atdheut,
Ku bora shkëlqen,
Ju, fshatra plot lule,
Dhe ti, o liqen,
Ty vend i rinisë
Të them përsëri:

Atdheu im i dashur,
Sa i ëmbël je ti!
Lahut' e malësisë

Ushton dhe kumbon,
Një krua nga shkëmbi
Ngadalë mërmëron,
Me grigje në brigje
Këndon një bari:


Atdheu im i dashur,
Sa i ëmbël je ti!

Atdheu im i dashur,
Të mundja t'i shoh
Liqenet e qeshur,
Luginat kudo.
Atje do t'gjej paqe,
Do t'gjej qetësi:

Atdheu im i dashur,
Sa i ëmbël je ti!

Sot dhimbjen që zemrën
Ngadalë ma copëton,
Ndër njerëzit e huaj
Asnjë s'ma kupton,
Prandaj ia marr këngës
Të mbushur me lot:

Atdheu im i dashur,
Sa larg më je sot!



SHKOLLA E PARË SHQIPE

Naim Frashëri

O vëllezër Shqipëtarë!
Gëzohi që erth kjo ditë
Kaq' e mir' e kaq' e mbarë,
Na sjell gjithë mirësitë.

Kjo është ditë e rezë,
Që bie vëllazërinë
E dëbon jetën e zezë
Dhe ndarjen e marrëzinë.

Ta lusim këtë ditë
Q'ë bekoj Zot' i vërtetë,
Dh'ë dërgoj me shumë dritë,
T'i mbes' emëri për jetë.

Sot e vumë gurr' e parë;
Sa'sht' e bekuar kjo ditë!
Zot' i math e pruftë mbarë
E na dhëntë urtësitë!

Hapu, hapu, errësirë!
Pa jakë tëhu, o dritë!
Se arriti koh' e mirë,
U gdhi nata, u bë ditë.

Sot niset një tjetër jetë,
Të rremenë posht' e shtije,
Mbretëron fjal' e vërtetë
Dhe të mirat gjith' i bije.



Zot' i math qoft' i lëvduar!
Q'ë nxjerr në shesht të vërtetën,
Se ajo sij ka buruar,
Pa e ka ndrituar jetën.

Kushdo që është sot burrë
Dhe Shqipëtar i vërtetë,
Emëri s'i shuhet kurrë
Dhe nderi i rron përjetë.

S'jemi grekër a bullgarë,
as gjë tjetër nukë jemi,
Jemi vetëm shqipëtarë,
Nji këtë emër nder e kemi.



POROSIA E GJON KASTRIOTIT PËR DJEMTË

Naim Frashëri

Gjon Kastrioti: “Ah! kam frikë prej mynxyre!
mos nuk’ i shoh më në jetë,
e të vdes nga mall’ i tyre,
ta lë dhe shtëpinë shkretë!”

Pastaj djemtë pran’ i mori,
i puthi e i qafojti,
psherëtimi fort i gjori,
lottë çurkë i lëshojti.

U thotë: “Të silli mirë,
të bëhi njerës në jetë,
të mos mbetni n’errësirë,
po të jini të vërtetë,

Nat’ e ditë të këndon
çdo q’u duhetë ta dini,
gjithë gjuhët t’i mësoni,
po shqipenë mos e lini;

Mirësit’ e Shqipërisë
i mbani, mos i harroni.
Mëmëdhen’ e kombin tuaj,
shtëpinë e njerëzinë
dhe atje në vënt të huaj
t’i doni, dhe miqësinë;

Shqipëtar’ e Shqipërinë
kurrë të mos i harroni,
kini dritë urtësinë
çdo gjë me mënt ta gjykoni;



Të bëhi trima të urtë,
të zottë të mbretëroni,
jo të marr’ e mendjeshkurtë,
ndaj duhetë të mësoni,

Shqipërija jush ka shpresë,
edhe pret shumë të mira,
po të mbani juve besë,
nuk’ e ha dot egërsira.



KLASA 6

RA SI YLL, PO S'U SHUA

Ismail Kadare

Vështroi princesha krenare,
në çdo gur e çdo kamare,
si të fundit roje ranë,
çdo pëllëmbë me gjak e lanë.
Dhe e vetme ajo mbeti
përmbi kullë.

Porsi deti, që i hedh dallgët në rërë,
turqit u sulën të tërë
që ta zënë yllin të gjallë ...
Po a zihet ylli vallë?!

Ja, Argjiroja e shpejtë,
tok me foshnjëzën e vet,
u vërvit si zog në erë,
nga kalaja në humnerë,
shkëmb më shkëmb seç u coptua,
ra si yll, po s'u shua ...

Në bedenat e zhuritur
mbetnë turqit të mahnitur,
të coptuar kur e panë:
«O Allah i lartë!» - thanë.

Rrotull malet oshëtinë,
vetëtinë e bubullinë.
Edhe shkëmbi ku u coptua,
thanë u drodh, u gjallërua,
dhe kujtoi ky shkëmb i bardhë,
se fëmija i saj mbetë gjallë
dhe, që foshnjën ta mëkojë,
qumësht zuri të pikojë ..
Se jetimëve që kanë lënë,
ata që në luftë kanë rënë,
dhe shkëmbinjtë u bëhen nënë!



Gjuha shqipe

FJALËT E QIRIRIT

Naim Frashëri

Në mest tuaj kam qëndruar,
E jam duke përvëlur,
Që t'u ap pakëzë dritë
Natën t'ua bënj ditë.

Do të tretem, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem,
Që t'u ndrinj mir' e të shihni,
Njëri-tjatrën të njihni.

Për ju do të rri të tretem,
Asnjë çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot,

Unë zjarrit nuk i ndruhem,
Dhe kurrë s'dua të shuhem,
Po të digjem me dëshirë,
Sa të munt t'ju ndrinj më mirë.

Kur më shihni që jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur,
Jam i gjall' e jam ndë jetë
Jam në dritë të vërtetë.

Unë jam në shpirtit tuaj,
Mos më kini për të huaj.
M'është falurë durimi,
Andaj po digjem si trimi,

Se ma kënda t'u bënj mirë,
Të mos mbeti n'errësirë.

Jakëni rreth meje rrini.
Flisni, qeshni, hani, pini.

Në shpirtit kam dashurinë,
Po digjem për njerëzinë,

Lemëni të përvëlohem,
Nukë dua më të ftohem.

Dua ta djek trupin e shkretë
Për atë Zotn' e vërtetë.

Me zjarr ta djek mushkërinë,
E të tretem për njerinë.

Bashkë me gëzimt të tija,
të vete te Perëndija.

Unë dua njerëzinë,
Mirësin' e urtësinë.

Në bëni shokë me mua,
Në më doni si u dua,
Njëri – tjetrinë në doni,
Të paudhë mos punoni.

O zemëra fluturake,
Qasju pakë kësaj flake,
Mbase krahët t'i përvëlton,
Po dhe shpirtin ta shenjtëron.

Unë duke përvëluar,
Njerëzit i kam ndrituar.

Kam qenë mik me njerinë,
Andaj i di e më dinë:



Gjuha shqipe

Gjithë tuajt i kam parë,
Mëm' e at' e fis' e farë,
Si tani gjith' i kam ndër mënt,
Që rrinë më këtë vent.

Edhe sot nër ju ata shoh,
Se shpirtin e tyre ua njoh,
Dhe unë si ju kam ndruar,
E jam përzjer' e ndryshuar.

Pa jam bërë shumë herë
Zjar e uj' e balt' e erë.
Jam një shkëndijë prej qielli,
Dhe një drudhëzë pej dielli.

Edhe ndër qiej fluturonj,
Edhe brenda në dhet qëndronj,
Shumë herë fle në baltë,
Diku ndodhem dhe ne mjaltë;

Bëhem qënq e kec i pirë,
Lul' e bar e gjeth i mbirë.

Dua shumë fjalë t'u them,
Po trembem mos i bënj ujem.

E ku shkruhenë në kartë
Fjalët e gjuhës së Zjartë?



Gjuha shqipe

VDEKJA E NOSITIT

Lasgush Poradeci

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i ap shpresë-edhe t'j-a mar...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zoqt-e mi,
Dh'u jap ushqim me dashuri-
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...,
Dh'e hap ah! gjirin më një ças...,
Dh'i nginj ah! zoqtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet
Pas mallit t'im liqeri-i shkret,
E rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mu në gjit, gjer mu në fund.

E shpirtin dyke ma përcjellë,
Më thotë-ah! shih sesa 'sht'i fellë
Ky gjir' i em që të pat pjellë...
... Me zjarr ju flas, me zjarr.

I MBETUNI

Ndre Mjeda

Për dhe t'vet tuj dal n'ushtri
Rrebtë qëndroi i ati e diq;
Sot i vorfni askund një shpi,
Nji copë buk' s'e gjen ndër miq.

Ah! Ti njome, o njome e mjera,
Dit' e natë që po vajton;
Kund ndër miq nuk t'çilet dera,
Kurrkush vajin s'ta pajton.

Dit' e natë pa bukë e shpi
Shkote i vorfni andej e këndej,
E prej t'pasunish zotni
Nji fjalë t'mirë kurrkush s'ia kthej.

Ku ke babën me t'ndihmue?
Ku ke nanën me derdh lot?
Ty gjith'robi t'ka harrue,
Kurrkush s'do me t'dalun zot.

Tuj ra borë, tuj fry murrhani,
Mjet dy vorreve si 'j lis,
Afër gropës që vet e bani
Djali i vorfën u molis.

Afër nanës u shtrua fjetun,
Afër babës kërkoi pushim;
Kurrnja t'ngritin s'ka me e gjetun,
T'nxet; e t'ftohtë s'kan' me pasë ndrrim.



FËMIJA

Ndre Mjeda

E kandshme asht hana
Kur del me zana,
E n'tokë me dritë përndaret.

Hyjzit që shndrisin
E që shëtisin
Npër qiell, janë t'bukur faret.

Kur del agimi
E rruzullimi
Me 'j dritë kuqloshe mbëlohet,
E përmbi kashta
Shndrit pika lashta,
Zemra me mall gazmohet.

Asht i madh shendi,
Kur ndihet shpendi
Ndër pyje tuj pingrue;

E knaqshme a'j lule
Kur ju përkule,
O flad i let, me e lmue.

Por s'i giet qielli,
Nuk i giet prilli
As flad që shëtit lulet
E me erna veshet,
Foshnjës që i qeshet,
Nanës kur mbi të përkulet.



KLASA 7

SHQIPTARIA

Ndre Mjeda

Kur n'kët shekull n'dritë e qite,
Kur e rrite
Me njat mund që nep hitia,
“Nji nanë tjetër, thoshe, ke,
Bir, n'ket' dhe,
Nana jote a Shqyptaria,

Mend e zemër për të shkriji,
E përtëriji
“Nam e lavd kur t'i vijë dita”

Mbas fjalësh t'tua përherë shkova,
E t'ndigjova:
Shqyptarinë nuk e korita.

E më thotë: o vlla, nji teje
Këto zemra për gjithëherë,
T'forcueme prej një feje
Rrahne n'këtë jetë të mjerë;
Një caku kje, nji shkëndija
E zemrës: Shqyptaria.

Po 'j dit' do t'vite e ma i lum do t'ishe
Ndër gjith' qytete me t'thirrur t'parin,
Kur n'nji kish' tande me mbajtun kisha
Ma t'madh Shqyptarin.



Gjuha shqipe

LAOKOONTI

Ismail Kadare

Tek më vini rrotull, unë them me vete
Kaq të verbër të jeni, sa mos ndieni këtë,
Që ky ngërç e ky ankth në gjithë qënien time
S'është nga gjarpërinjtë, por nga tjetër gjë.

O sikur të mundja gjithçka të tregoja,
Si do të ngrinit para meje si gur,
Por unë jam i dënuar mes rropamës tuaj
moskokëçarëse, monologun të thur.

Pajtim me armikun, ulërinin tradhëtarët,
Mjaft më me luftë, zjarre dhe helm.
Erdh'koha që shpatat t'i kthejmë në parmenda,
Armiaqtë në miq erdh' koha t'i kthejmë.

Në mbledhje të gjatë “pro” dhe “kundra” kalit,
Unë “kundrat” kryesova me tërbim.
Dhe juve ju kanë thënë se aherë hyjnitë
Gjarpërinjtë më dërguan si ndëshkim.

Atë kalë unë i pari e kisha goditur,
Ndaj, e dija, këtë s'do ma falnin përjetë.
Më në fund “vijë e butë” fitoi mbi “të ashprën”
Dhe ne, “kokëfortët”, na vunë në arrest.



Në burg, me gotën e ujit, në mesnatë
Helmin më dhanë ata të pi,
Ata që ulërinin kundër dhunës dhe shpatës,
Që dinin të kafshonin tamam si gjarpërinj.
Në mëngjes që pa gdhirë në breg të detit
Ma hodhën kufomën drejt mbi zhavorr.
Rapsodët aherë anembanë përhapën
Versionin fals të gjarpërinjve hyjnorë.

Ky ishte mbarimi i polemikës për kalin,
Ju e dini me Trojën ç' ndodhi pastaj,
Tre mijë vjet rresht, nga muzeu në muzera
Unë hamalli i mermertë gënjeshtrenë mbaj.

Më kanë lodhur më shumë, besomëni ca fjalë,
Se kjo peshë e neveritshme gjarpërinjsh.
Ju, që gjer në hënë keni shkuar, si vallë
S'depërtoni dot gjer në gjoksin tim?

Dëgjoj emra shtetesh të reja që kanë dalë,
Emra kombesh e popujsh të rinj dëgjoj,
Veç ai, i vjetri, i tmerrshmi kalë,
Ashtu si aherë ka mbetur njëlloj.

BALADA E ZOGUT TË VOGËL TË DALLËNDYSHES

Mitrush Kuteli

Sa e bukur është toka, sa i ndritur është dielli,
porse zogut të uritur sterrë e pus i duket qielli.

Ku më është nëna ime? A mos vallë më harroi?
Nuk e di se jam i mitur, krahë s'kam të fluturoj?"

Ku ta dinte zogu i mitur, se në çastin kur mbaroi,
zemra e nënës ditëzezë porsì gjëmë uturoi.

Jo për veten, po për foshnjën, që e linte pas jetim
rrahu zemra e saj e djegur si buçim që vrungullin.

Erdhi nata, shkrepën yjtë, edhe prapë u bë mëngjes.
"Do të vdes! – tha zogu i vogël – Po pa rrojtur qysh
të vdes?"

Jeta është kaq e ëmbël, bota plot me bukuri,
dhe në bar, në lule e drurë gjenden kaqë ëmbëlsi .

Ah, sikur të dal në botë, nënën time të kërkoj!
Të hap krahët ...
Po s'kam pendë e nuk mund të fluturoj!

Po kështu, siç jam, do nisem: nënës do t'i vete pas,
të më sjellë rishtas në jetë, të më japë rishtas gas!"

Si ato që hiqen zvarrë dhe ato që fluturojnë,
si ato që çajnë ujrat – nënën kurrë s'e harrojnë.

"Po tani? – pyeti zogu – Ç'do të bëj unë tani?"
"Do të bësh siç bëjnë të gjithë: do të nxjerrësh zogj
dhe ti!"

Unë e di, moj shoqe fqinjë: vogëloshi do ushqim,
jam i rrahur nga e zeza, se kam qenë e jam jetim.

Do mundohem që fëmijët të mos shohin varfëri
e të rriten të gëzuar, me shëndet e lumturi.

Ja, kështu vazhdon kjo jetë, dit për ditë e ças për ças:
ka mjerime, dëshpërime – po na ka dhe jetë e gaz.

POROSITË E PERËNDISË PËR NJERIUN

Naim Frashëri

Perëndija njerin' e parë e mori pej dore vetë,
E zbriti mbi faqet të dheut, q'ish me lulez'e me fletë,

Më të drejtënë të themi, mbi faqet të dheut engriti,
E bëri të zotthin'e dheut edhe kështu e porositi:

Nga kjo baltë të kam bërë, rri këtu, në paç uratë,
Mos u lodh e mos psho kurrë, po përpiqu dit' e natë,

Sheh si punon gjithësija, ashtu të punosh edhe ti,
Të mos rrish kurrë pa punë, e të vësh duartë në gji.

Mos u bëj i lik e i keq, i paudh' e i pabesë,
I rrem, i ndyrë, i dëmshim, i rënduar e pashpresë,

Mërgohu nga të këqijat, pej çdo fare ligësisje,
Pej nakari, pej lakmimi, pej vjedhje, pej marrëzije,

Mos vra, mos merr tek s'ke vënë, edhe ki nom dashurinë
Bes' e fe ki urtësinë, të drejtënë, mirësinë.

Në bëfsh mirë, liksht s'gjen kurrë,
po në bëfsh liksht, mos prit mirë,

Ki dëshirë për të mirë, dhe në zëmërë mëshirë,
Ji i but', i urt', i vjyer, e mos u bëj kurrë makut,
I egër' e i mërziur dh'i mahnitur e ladut,

Mos ju afro dhelpërisë, po së drejtësë ju nis pas;
Në dëgjofsh fjalët e mija, do të jesh gjithnjë në gas.

Nga gjithë ç'pat gjithësija, të kam dhënë dhe ty pjesë,
Në u bëfsh si them, i mirë, emr'i math do të të mbesë.

Të kam dhënë mënt, të mësosh, të vërtetën me të ta shohç,
Dhe zëmër' e vetëdijë, të mir', e të drejtë të njohç,



Gjuha shqipe

Do të të lë dhe nevojën, udhënë të të tregonjë,
Të të ndihnjë më çdo punë, të të psonj' e të të zgjonjë.

Gjithë të mirat që janë, këtu në dhet i kam mbluar,
Po gjësendi në shesh s'nxjerr dot pa dirsur e pamundur,

I gjen të gjitha me kohë, po rrëmo thellë e më thellë,
Çdo gjë duhet kërkoje, barku i tij do ta pjellë.

Sa gjërërazë të vlera do të gjesh ti këtu brenda,
Edhe përsipërë soje, e sa do të t'i ket' ënda!

Me fuqit, që të kam dhënë, them që të vinjë një ditë
Të marrç udhën e së mirës e të gjesh të madhe dritë,

Të març vesh dalengadale sa punëra, që kam bërë,
Diell, hënë, yj, dhe, qiej e gjithësinë të tërë!

Po që u bëre i urtë, mua më ke afër teje,
Ndryshe, - qofsh i mallëkuar, edhe mërguarë meje!

Të parit tënë Perëndija këto fjalë vetëm i tha,
I fali gjithë të mirat, i dha uratën dhe e la.



BILBIL I VENDEVE TË MIA

Lefter Çipa, Himarë (Kënduar nga grupi i Pilurit)

Ku peshon më shumë guri,
ku s'ka të vdekurë burri,
more Naim Shqipëria?

Peshon në vendin e tija,
ku të flet gjuhën fëmija.
Bilbil i vendeve t'mia!

O pena me flori larë,
mbi botë lulja e parë,
more Naim Shqipëria.

Hënë yjesh, hën' behari,
ç'u bë Naim Shqipëria?
Bilbil i vendeve të mia!

Gjuh' e zogjve nëpër djepe,
zgjove kombin, dritë derdhe,
bilbil i vendeve të mia,
bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,
more Naim Shqipëria.

Pak jetove, shumë na le,
shumë more dhe në dhe.
Bilbil i vendeve të mia,
bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,
bilbil i vendeve të mia.

S'të mban dot dheu përbrenda,
del nga varri e nis nga kënga,
more Naim Shqipëria.

Shqipëri, o shkëmb i sertë,
ti bilbila i bën djemtë,
shekujt vin e vitet shkojnë,
Naim djemtë ligjërojnë.

KROI I FSHATIT TONË

Lasgush Poradeci

I Kroi i fshatit tonë, ujë i kulluar,
Ç'na buron nga mali duke murmuruar.

Venë e mbushin ujë vashat an'e-mbanë
Cipëzën me hoje lidhur më-nj'-anë;

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
Gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu ç'm'j-u ka hije!
Ndaj këthehen prapë me hap nusërie:
Ndezur ylli i ballit si yll shentërie.

II Kroi i fshatit tonë, ngjyrë argjend i lyer,
Që nga rrëzë e malit, ç'na buron rrëmbyer.

Venë pijnë ujë trimat anembanë,
Takijen me lule përmbi sy mënjanë.



Takijen e dliirë, takijen e nxirë,
Buzën më të qeshur... më të psherëtirë.

Mbrëmave kur uji mërmëron ngadalë,
Vjen t'i thotë trimi vashës nj'a dy fjalë:

Vazhëzën bujare që po vij më krua
Seç e përshëndeta, seç m'u turpërua,
Papo ula kryet e shkova si grua.

III Kroi i fshatit tonë tetë sylynjarë,
Në tetë krahina qenka kroi i i parë.

Qenka një në botë, s'paskërka të dytë,
Ç'na shëroka plagët, ç'na shëroka sytë.

Kroi i fshatit t'onë në atë mal me fletë,
Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
Posi mall'i zemrës mun në gji të shkretë:

Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë.
Posi mall'i vashës, që djeg më të fshehtë,
Posi mall'i trimit, që buçet përpjetë,
Obobo! si malli, që nuk vdes përjetë.



KLASA 8



POROSIA E GJON KASTRIOTIT

Naim FRASHËRI

Gjon Kastrioti: “Ah! kam frikë prej mynxyre!
mos nuk’ i shoh më në jetë,
e të vdes nga mall’ i tyre,
ta lë dhe shtëpinë shkretë!”
 pastaj djemtë pran’ i mori,
 i puthi e i qafojti,
 psherëtiti fort i gjori,
 lottë çurkë i lëshojti.

U thotë: “Të silli mirë,
të bëhi njerës në jetë,
të mos mbetni n’errësirë,
po të jini të vërtetë.
 Nat’ e ditë të këndon
 çdo q’u duhetë ta dini,
 gjithë gjuhët t’i mësoni,
 po shqipenë mos e lini;

Mirësit’ e Shqipërisë
i mbani, mos i harroni.
Mëmëdhen’ e kombin tuaj,
shtëpinë e njerëzinë
dhe atje në vënt të huaj
t’i doni, dhe miqësinë;

Shqipëtar’ e Shqipërinë
kurrë të mos i harroni,
Kini dritë urtësinë
çdo gjë me mënt ta gjykoni;

Të bëhi trima të urtë,
të zottë të mbretëroni,
jo të marr’ e mendjeshkurtë,
ndaj duhetë të mësoni,

Të bëhi shumë të ditur,
fjalëbukur’ e të çquar,
shpirtdashur’ e mendjendritur,
të mir’ e të kupëtuar.
 Zoti e nderoj njerinë,
 i dha mënt që të gjykonjë,
 të punonjë mirësinë,
 të ligatë t’i mërgonjë;

Ruani nder’ e shëndenë,
burrërin’ e trimërinë,
kombin’ edhe mëmëdhenë,
njerëzin’ e mirësinë.

Shqipërija jush ka shpresë,
edhe pret shumë të mira,
po të mbani juve besë,
nuk’ e ha dot egërsira.

Mësimet do t’u mësojnë
ato punëra, q’u duhen
atyre që mbretërojnë,
e mbretrë të mirë quhen;

U duhetë njerëzija,
zotërija e të tjera,
mirësija, trimërija,
gjithë vetijat’ e vlera;

Kombinë shumë ta doni,
e si fëmijë ta kini,
me të drejtë të gjykoni,
e çdo punëzë ta dini;

Dhe në brengë të mësohi,
dhe shpirtinë ta mundoni,
e kurrë të mos rëndohi
në doni të mbretëroni;

Kini njohë të qëruar,
dhe ndjenja të larta shumë,
zëmër edhe shpirt të çquar,
mëndje pa lodhje e pa gjumë”.

NAIM FRASHËRIT

Lasgush PORADECI

Ku psherëtin dëshir’ e djegur,
Në shesh të kuq të Qerbelasë,
Mes trimërish shtërgjyshërishte
Të shoh tek po m’i bje xhurasë.

E me të lum, me të përmallshme
Të sjell në dritën e mejtimit
Ndaj fërfëllon si yll me flakë
Prej shkretëtirës së harimit:

Qëndroj në tmerr zili’ e botës
Se më s’u lodhe dyke ndritur,
Se më s’të treti prush’i vojtjes
Në kraharorin e zhuritur.

Po ti me vrap të piraustit
Që fluturon në zjarr e flakë,
Therorësin’ e vetëvetes
E pate dhimbjen më të pakë ...

O, sikur këng’ e zemrës s’ate
Që ligjëroj aq më të kotë,
Që veç me fjalë dhembshurije
U pat dëgjuar përmbi botë,



Gjuha shqipe

Në gji të çdo mëmëdhetari
të mund t’a përtëritte mallë
Dhe një të tërë varg dëshirash
Q’i thurri mendja jote-e rrallë,-
Me ç’zë të pastër lavdurimi
Do kish bekuar varfëritë!
Vaj’ e një çasi-i këngës s’ate
Përjetësisht do dil në dritë!

Po t’u pat thënë short’ e verbër
Të përvëlohesh nër padije:
Me mijë rreze shkrepëtimi
Mezi të ndritish po një fije ...

Dh’aher’ i dehur prej durimit,
Në mall të math të këngës s’ate,
Kaq zilitar këpute zemre
Ç’më të paçmuarshmë ti pate.

Dh’u ngrite për në të vërtetën
Me fluturim të artit mjeshtër:
U drodh alltari jon’ i lashtë
Sapo t’a ndjeu të shentën është ...
Se ngashërim’ e vjershës s’ate
Ish mall i fellë-e pa të ngjarë,
Posi një krua pastërsije
Këndimi yt nër ne pat rarë;

U pat tërhedhur shpirt' i kombit
N'atë vajtim aq të lënduar
Q'e thurri gjuha jote-e-zjarrtë,
Dhe balli yt i frymëzuar;

Se bukuritë-e vetes s'onë
Mendimi yt desh të na falë,
O! Fjal' e pikave qiriri,
E pika lotëvet o Fjalë!

Q'ahere dyke shpënë sytë
Nga Toskëri' e Gegërija,
Shpesh e më shpesh patm'ëndërruar
Si ndrin në famë Shqipëria.

Mes ligësish armiçërishte
Stolismë lulen e vullnetit ...
Sbuluam gur margaritari
Prej fundit thëthimtar të detit ...

E m'i çkëlqyer sesa djelli,
M'i lum se kohët që më s'janë
Filloi për ne ndryshim i motit
Me një të pritme të pa anë:

Ti! Fjalëtor i mallëngjyer!
Ti! Këng' e rritur ndaj selvisë!
Ti! O rapsod i lasht' i kombit,
Ti pate pjes-urgjin' e zisë!-

A! po n'u trete prej mendimesh
Me tëmbra t'ulura nër duar:
Në ç'qjell të larg pat gjetur prehje
Kjo zemra jote- e përvëlur?

Nga fluturoi bilbil finoshi
Q'e fryri era posi fletë?
Ku vanë pendët e pëllumbit
Q'e shtiu në dhet mërgim' i shkretë?
Sikur të shoh, i tmerrshmë Frashër,
Tek po mban zi përgjithmonë,
Ti: më besniku trashëgonjës
I dashuris' së vendit t'onë.



DREMIT LIQERI

Lasgush Poradeci

Mbi zall të pyllit vjeshtarak
dremit liqeri pa kufi,
ay ndaj fundesh u përflak
posi me zjarr e me flori.

Posi me flakë-u ndes e kroj,
E vetëtiti plot magji,
E yll' i ditës perëndoi
Në qetësi dhe dashuri.

Tashi po shuhet nënë mal
Qytet' i ngrysur në të zi.
Po ndizen yjtë dal-nga-dal
plot bukuri, plot fshehtësi!

Në këtë çast perëndimor
Ndaj po më dehen syt-e mi,
kuptoj si shpirtin vjershëtor
M'a frymëzon një mall i ri.

TË LINDET NJERIU

Migjeni

Të lindet një njeri
nga gjin' i dheut tonë të rim me lot të vakët,
nga thalb' i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të
flakët
për një gen të ri.

Të lindet një njeri!
Pa hyll në ball, por që me fjalë të pushton,
që të rrëmben qetsin e ban gjakun të të vlojë
rrkajë, e ban synin ligshtin të zgjetojë,
që nëpër shekuj ndërgjegjen na tradhton.
Të dali një njeri!
Të mkambi një Kohë të Re!
Të krijojë një Epopë!
Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re ...

Të gjithë kombet po dehen n'epopea të veta,
flakë e zjarrmit të tyne na i përzhiti ftyrat
dhe nëpër to një nga një po shtohen rrudhat,
e nën këmbë e mbi krye tinzë po na ikën jeta.

(Liri! – Po, liri dhe gaforrja gëzon,
por gaforre asht...
Liri, ku plogsi ndërgjegje gjallon,
jo, liri nuk asht!)

Të lindet një njeri
i madh si madhni
dhe ndërgjegjet tona t'i ndezi në dashni
për një ide të re, ideal bujar,
për një agim të lum e të drejtë kombtar.



Gjuha shqipe

ANKESAT NDAJ PERËNDISË

Ali Asllani

E pra, ti, o perëndi,
pse na le në dorë të djallit,
që na shtypi, na përtypi
nëpër nofulla të çakallit?

Po tani u bë ç'u bë,
ti, o zot i këtij dheu,
s'mund të bësh asgjë,
t'i thuash kohës: prapa kthehu!

Edhe rri e bën sehir,
bën sikur asgjë nuk di,
pra dhe neve jemi kundra,
duam një tjetër perëndi!

Duam një zot që do të mund
të na kap' e të na tund,
të na tund e të na shkund,
vëllavrasjes t'i jap fund.

Perëndi, o perëndi,
vi përpara zotris' sate,
duke pasur përmbi supe
një vandak të rënd' mëkate,



po mëshira hyjnore
është' e thell' e është' e gjërë
më e thellë nga gjith' mëkatet
që ka vendi yn' i tërë.

Po më fal për këto fjal',
që guxova e i thashë,
i rrëmbyer e i trembur,
mbasi gjuha më rreh dhëmbin,
atë dhëmb që më ka dhëmbur.

Vendi ynë që ka jetuar
herë me pushkë e her me shat,
s'mund të lihet tash e tutje
si një flet' në degë të that',

Ai lipset që të rrojë,
qoft' me hir' e qoft' pa hirë,
dhe aty ku bie zjarri,
bëhet lulja më e mirë.



KLASA 9

KOLEGJA

Ernest Koliqi

Ju falem,
o bajama t'lulzuem t'kolegjës s'eme,
pse ju kët fllad prej s'largu po m'a çoni.
Kur ju çilshi në prill bashk' me qershija,
kumbulla e pjeshka atbot' kolegja dukej si djep lulesh.
Edh'ishte!

Sa e sa mija shpresash krenare ka përkundë
e andrra t'bukura, kur jashta shekullit jetojshim
si n'nji ishull magjik ...
Nxanës i hovshëm,
synin nga librat plot dëshirë e lshojsha
përtej atyne ledheve, - mbi jetën ...

Shpesh-hera mallëngjyeshëm zani msuesit
na thonte, po, se jeta a plot mashtrime
e se të shumtën ndodh' qi n'udha t'saja
i drejti vuen edhe ngadhnjen bakeqi.
Kush e ndëgjonte?

Me një hark si ylberi premtimesh i rrethuem,
na çfaqej para vegimi i jetës.

Kur dhe librat thojshin
se bahen t'mdhaja paudhësi,
na n'parzem ndiejshim
një shpirt e një guxim pushtuesash
qi zbresin me i vu ligjën dheut t'fituemun me shpatë.

O botë e njerzve, n'vete ushqejshim
shpresën hyjnore, shpresën guximtare
qi vepra e jon' ty shqim do t'kish përtrimun
tu' e kthye prap jetën n'bukurin e prallave ...
Ku asht ai shpirt? Pse s'jam prap ai?



Gjuha shqipe

Tet'heresh ende s'ia a siellun bota rrolles s'diellit, -
e kam ndrrue krejt ... un qi desha t'ndroj botën!
Kush m'qiti kaq me shpejt nga praku
I heshtëshëm i shkollës s'eme? E ku jam sot?



Sakt, n'andërr.

HAKËRRIM

Ali Asllani

Hani, pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!

Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakenjvet;
hani, pini e rrëmbeni, është bot e maskarenjvet;

dhe kolltuku ku ke hipur, duke hequr nderin zvarrë,
është trikëmbëshi që përdita varet kombi në litar!

E na tunde, na lëkunde, nëpër salla shkon e shkundet,
mbasi dora e armikut ty me shok' të heq për hunde.

Rroftë miku yt i huaj, që për dita los e qesh,
të gradoi katër shkallë, pse i the dy fjal' në vesh!

Koha dridhet e përdridhet, do vij' dita që do zgjidhet
dhe nga trasta pem' e kalbur deomos jasht' do hidhet!

Koha dridhet e përdridhet, prej gradimit katër shkallë
nuk do mbetet gjë në dorë veçse vul' e zez' në ballë!

Mirpo ju që s'keni patur as nevoj' as gjë të keqe,
më përpara nga të gjithë, ju i that' armikut: "Peqe!"

Që të zinit një kolltuk, aq u ulët u përkulët,
sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!

Dallavera nëpër zyra, dallavera në pazar,
dallavera me të huaj, dallavera me shqiptar'

Vetëm, vetëm dallavera, dhe në dëm të këtij vëndi
që ju rriti, që ju ngriti, që ju ngopi, që ju dëndi!

Nëse kombi vete mbarë, nesër ju vepronindryshe,
dylli bënet si të duash, kukukavajk' dhe dallandyshe...

kukuvajka gjith' me lajka, nesër silleni bujar,



Gjuha shqipe

nënë dorë e nënë maska, shkoni jepni një kapar!

Dhe kujtoni tash e tutje me të tilla dallavera
kukuvajka do përtypi zog e zoga si përhera...

Ja, ja, grushti do të bjeri përmbi krye të zuzarve,
koha është e maskarenjve, po Atdheu i shqiptarëve!

Edhe ju të robëruar, rob në dor' të metelikut,
fshini sofrat e kujtdoj', puthni këmbën e armikut!

Që ta kesh armikun mik e pandehni mënçuri,
mjafton bërja pasanik, pasanik dhe bej i ri,

dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vetura,
kurse burrat më fisnikë japin shpirtin në tortura!

Vëndi qënka sofr' e qorrit, vlen për goj' e për lëfytë,
bëni sikur veni vetull', shoku shokut kreni sytë...

Dhe për një kërkoni pesë, po më mir' njëzet e pesë.
Le të rrojë batakciu dhe i miri le të vdesë!

A e dini që fitimi brënda katër vjet mizor'
nuk është yti, nuk është imi, është i kombit arbëror,

është i syrit në lot mekur, është i vendit djegur, pjekur,
Ju do thoni si të doni... po e drejta dërmon hekur!

TË BIRTË E SHEKULLIT TË RI Migjeni

Na të birtë e shekullit të ri,
që plakun e lamë në “shejtnin” e tij
e çuem grushtin për me luftue
ndër lufta të reja
dhe me fitue

Na të birtë e shekullit të ri,
filizat e një toke së rimun me lot,
ku djersë e ballit u dikonte kot –
se dheu ynë qe kafshatë e huej
dhe në marrzi duhej shumë shtrejtë t’u paguhej ...

Na të birtë e shekullit të ri,
vllazën të lindun e të rritun në zi,
kur tinglloi çast’i ynë i mbramë
edhe fatlumë
ditëm me thanë:
S’duem me humbë në lojë të përgjaktë të historis
njerëzore,
jo! jo! s’i duem humbjet prore –

duem ngadhnim!
ngadhnim ndërgjegje dhe mendimi të lirë!
S’duem për hir
të kalbsinave të vjetra që kërkojnë “shejtnim”,
të zhytemi prap në pellgun e mjerimit
që të vajtojmë prap këngën e trishtimit,
kangën monotone, pa shpirt, të skllavnis –
të jem’ një thumb i ngulun ndër trutë e njerëzis.

Na të birtë e shekullit të ri,
Me hovin tonë e të ndezun peshë,
ndër lufta të reja kemi m’u ndeshë
dhe për fitore kem’ me ra fli.



Gjuha shqipe

DASHURIA E SKËNDERBEUT

Naim Frashëri

Nga Skëtterra duke dalë,
Ëngjëlli i urtësisë
mbretit i tha këtë fjalë
me zëthit të Perëndisë:

“Skënderbe! t’u ngjattë jeta!
Mbret’i mir’i Shqipërisë!
mos u ndaj nga e vërteta
dhe nga udh’ e Perëndisë”.

Po kur ngrihetë Nakari
me fytyrë të mërëzitur,
si i vdekuri nga varri,
i tretur e i venitur,
armiku i Perëndisë
ishte shumë’ i zëmëruar,
vat’ e ju lut Dashurisë,
fytyrën duke ndryshuar,

i tha: “Mbret’i Shqipërisë
më shpërnderoj këtë herë,
s’ju qas fare ligësisë,
ma hodhi në baltë nderë;
pa në zëmërë ndjen një plagë
e ti, ke fuqi shumë,

të më març sot soje shpagë,
ta hedhç në prëhjë e në gjumë”.

Kështu tha i zëmëruar,
u lëshua Dashurija
nd’erë duke fluturuar
me shigjeta të këqija!

Ngadalez’i afërohet
dh’e përkëdhel mbretëreshën,
pa ajo shumë gëzohet,
se ja mer nga mëndja peshën!

Sa më shumë e përkëdhelte,
bukurija aq’ i shtohet,
nga faqetë zjarr i delte
dhe sa vinte xbukurohej.
Ahere me një shigjetë
Dashurija e goditi
mbrenë ndë zëmërt të qetë,
me vërtik shumë e vërviti.

Në zëmërt i ndënj shigjeta
me të madhe ëmbëlsirë,
oh! sa është e ëmbël’ e shkreta!
kur e mer zëmërin mirë.

Qysh vetëtin më fort moti
edhe shkrepëtin pa prerë,
kur na dërgon shinë Zoti,
e rrit luletë në verë?

Ashtu edhe Dashurija
shigjetatë këtë herë
të hollazë posi shtija
i heth fët-e-fët pa prerë!

Pa mbreti ishte goditur,
gas të math në zëmërt ndjente,
posi djalëth i nemitur,
Dashurija e gënjente!



Gjuha shqipe

Dashuri’ e Bukurija
bashkë të dyja u bënë,
me shigjetat’ e këqija
mbrenë posht’ e kishin vënë!

Atë, q’ ishte trim e burrë!
s’e zij as ushta as shpata
as shigjet’ e luftës kurrë,
e shtu poshtë jetëgjata!

Kur e pa kshtu Urtësija,
zu për dore Trimërinë,
“Jak’, i tha, se Dashurija
rreh të na mbyllnjë shtëpinë”.

Kshu i tha dhe fluturuan
të dyja si dallëndyshe,
me vrrap të shumë nxituan,
s’ndënjn’ e nukë bënë ndryshe,

po erdhë drejt e te mbreti,
të dyja në mest e vunë,
hu qasnë pranë së qeti,
dh’e muarr’ e jasht’ e shpunë.

GJUHA SHQIPE

Gjergj Fishta

Pra, mallkue njai bir Shqyptari,
Qi ketë gjuhë të Perëndis,
Trashigim, qi na la i Pari,
Trashigim s'i a len ai fmis;

Edhe atij i u thaftë, po, goja,
Qi e përbuzë kët gjuhë hyjnore;
Qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
Flet e t'veten len mbas dore.

Në gjuhë shqype nanat t'ona
Shi prej djepit na kanë thanun,
Se asht nji Zot, qi do t'a donna:
Njatë, qi jeten na ka dhanun;

Edhe shqyp na thanë se Zoti
Per Shqyptarë Shqypnin e fali,
Se sa t'enden stina e moti,
Do t'a gzojn kta djalë mbas djali.

Pra, Shqyptarë, çdo fes qi t'jini,
Gegë e Toskë, malci e qyteta,
Gjuhen t'uej kurr mos t'a lini,
Mos t'a lini sa t'jetë jeta.

Por per te gjithmonë punoni;
Pse, sa t'mbani gjuhen t'uej,
Fisi i juej, vendi e zakoni
Kanë me u mbajtë larg kambet s'huej.

Nper gjuhë shqype bota mbarë
Ka me u njohtë se ç'fis ju kini,
Ka me u njohtë ju per Shqyptarë:
Trima n'za sikurse jini.

Prandej, pra, n'e doni fisin,
Mali, bregu edhe Malcija
Prej njaj goje sod t'brohrisin:
Me gjuhë t'veten rrhoftë Shqypnija!



Gjuha shqipe



*Flamuri i Shqipërisë
dhe i shqiptarëve*



udha e shkronjave



Olimpiada XXIII Kombëtare
"Udha e shkronjave"
nëntor 2023
